



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
TIRANE

NR. 13522/12894 AKTI

NR. 613 VENDIMI

VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKES

Gjykata Administrative e Apelit, në trup gjykues të përbërë nga:

ENKELEJDA METALIAJ(SOFTA)-----Relatore;
ARDIAN DVORANI-----Anëtar;
BLERONA HASA-----Anëtare;

Asistuar prej sekretares Ivi Halipaj sot më dt. 12.12.2022, pasi mori për shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative me nr. 13522/12894 me palë:

PADITËS: Ylli Tuga, i biri i Hajdarit dhe Hajries, i datëlindjes 08.07.1973, lindur në Gjom: Krujë.
Gjok Çoba, i biri i Mark dhe Mare, i datëlindjes 10.10.1949, lindur në Krujë.
Shefqet Basha, i biri i Bajram dhe Fatime, i datëlindjes 20.11.1961, lindur në Muzhal Burel dhe banues në Kurbin, Laç.
Arjan Çoba, i biri i Zef dhe i Prene, i datëlindjes 04.07.1979, lindur në Laç dhe banues në Kurbin. Të përfaqësuar në këtë gjykim nga Av. Eda Grimçi, me Nr. Liçence 6275, sipas prokurës së posaçme nr. 1578 Rep, dhe nr. 1016 Kol, datë 22.06.2020.

E PADITUR: Bashkia Kurbin, përfaqësuar në këtë gjykim nga Eneida Gjonaj, sipas autorizimit nr. 4909/2 Prot, datë 14.10.2022.
Instituti i Ndërtimit, përfaqësuar në këtë gjykim nga Elona Bushpepa, sipas autorizimit nr. 1632/1.Prot, datë 27.10.2022.
Avokatura e Shtetit, përfaqësuar në këtë gjykim nga Ermjona Sotiri.

OBJEKTI: Konstatimin e paligjshmërisë së veprimit tjetër administrativ "Njoftim për shembjen e pallati", datë 18.06.2020, të afishuar nga pala e paditur Bashkia Kurbi n në ambientet e Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, Lagja Nr.3, Laç, Kurbin.
Shfuqizimin e aktit të ekspertimit të bërë nga pala e paditur Insituti i Ndërtimit, njoftuar me shkresën nr: prot 1244, datë 03.06.2020, si akt i paplotë i pambështetur në ligj dhe në prova.

Detyrimin e palës së paditur Instituti i Ndërtimit për kryerjen e aktit të vlerësimit të kostos së ndërtimit, dhe kostos së riparimit të Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, Lagja Nr.3, Laç, Kurbin.
Detyrimin e palës së paditur Bashkia Kurbin për kryerjen e veprimeve administrative për riparimin e plotë të Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, Lagja Nr.3, Laç, Kurbin.
Detyrimin e palës së paditur për pagimin e të gjitha shpenzimeve gjyqësore dhe avokatore.

BAZA LIGJORE:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë: Nenit 3, 7/a, 11/1, 15, 17/c dhe vijues të Ligjit nr. 49/2012 "Për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"; Kodi i Procedurës Administrative; Kodi i Procedurës Civile; Akti normativ nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 3356, datë 15.12.2020, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesë padisë së paraqitur nga pala paditëse Ylli Tuga, Gjok Çoba, Shefqet Basha, Arjan Çoba.*
- *Konstatimin e paligjshmërisë së veprimit tjetër administrativ "Njoftim për shembjen e pallati", datë 18.06.2020, të afishuar nga pala e paditur Bashkia Kurbin në ambientet e Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, vendndodhja: Lagja Nr.3, Laç, Kurbin.*
- *Shfuqizimin e aktit të ekspertimit të bërë nga pala e paditur Instituti i Ndërtimit njoftuar me shkresën nr. prot 1244, datë 03.06.2020.*
- *Detyrimin e palës së paditur Instituti i Ndërtimit për kryerjen e aktit të vlerësimit të kostos së ndërtimit, dhe kostos së riparimit të Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, vendndodhja: Lagja Nr.3, Laç, Kurbin.*
- *Detyrimin e palës së paditur Bashkia Kurbin për kryerjen e veprimeve administrative për riparimin e plotë të Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, vendndodhja: Lagja Nr.3, Laç, Kurbin.*
- *Bazuar në nenin 40/2 të Ligjit nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", ligjërimin e masës së sigurimit të padisë të vendosur me Vendimin nr. 62(3112202399-80-2020) Rregj. Them, datë 26.06.2020 të Gjykatës Administrative të Shkalles së Parë Tiranë.*
- *Bazuar në nenin 41 të Ligjit nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", vendimi i Gjykatës, është titull ekzekutiv dhe është i ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor menjëherë.*
- *Shpenzimet gjyqësore të kryera për llogari të këtij gjykimi, ku përfshihen, taksa mbi aktet dhe njoftimet e paguar nga pala paditëse në masën 3300(tremijë e treqind) lekë, shpërblimi i avokatit të palës paditëse në masën 40.000(dyzetë mijë) lekë, siç është përcaktuar në aktet nënligjore në fuqi, shpenzimet e tjera gjyqësore, shpenzimet e procedurës së ekzekutimit dhe tarifa për vënien në ekzekutim, sipas nenit 102 dhe 106 të K.Pr.Civile dhe nenit 41 dhe 66 të ligjit nr. 49/2012 "Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", i ngarkohen për shlyerje palës së paditur Bashkia Kurbin.*

- *Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve, afat ky që fillon nga e nesërmeja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.*

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim, pala e paditur Instituti i Ndërtimit i cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Si pasoje e tërmetit të datës 26.11.2019 nga ana e Qeverisë Shqiptare u morën disa masa emergjente. Me datë 27.11.2019 doli VKM nr. 750 "Për shpalljen e fatkeqësisë Natyrore në qytetet Durrës Tiranë" i ndryshuar, kjo në përputhje dhe Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile me qëllim kryesor parandalimin dhe mënjanimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.
- Nga bashkitë e dëmtuara nga tërmeti, institucione të ndryshme, autoritetet përgjegjëse si dhe nga Instituti i Ndërtimit u ngritën grupe përkatëse inspektimi për konstatimin e dëmeve të shkaktuara nga ky termet.
- Në lidhje me objektin, pallati 84 (41) rruga Gjimnazisti Laç grupet e inspektimit (të Bashkisë Laç) të ngritura për inspektimin e objekteve të dëmtuara nga tërmeti pas verifikimit të gjendjes së objektit dolën me akt konstatime përkatëse për secilën nga shkallët e Pallatit nr. 84 si më poshtë vijon:
- Akt konstatimi i datës 06.12.2019 pallati 84 shkalla nr. 1, në përshkrimin e dëmeve thuhet plasaritje e dyshemesë. Çarje të thella të mureve kryesore dhe anësore nga themeli e lart. Cedim themeli. Gjendja e ndërtimit sipas këtij akt konstatimi i pabanueshëm. Akt konstatimi për shkallën e 2 të të njëjtit objekt në përshkrimin e dëmeve thuhet: çarje të thella të mureve kryesore dhe anësore që fillojnë nga themeli e lart me tendencë cedim themeli në disa pika. Plasaritje e dyshemesë. Ndërkohë që gjendja e ndërtimit është i pabanueshëm. Akt konstatimi i shkallës nr. 3 të të njëjtit objekt në përshkrimin e dëmeve thuhet: Plasaritje në muret mbajtës, çarje të thella të mureve kryesore në katin e parë. Ndërkohë që gjendja e ndërtimit është i pabanueshëm.
- Me datë 16.12.2019 del Akti Normativ nr. 9 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore. Qëllimi i këtij akti normative është përballimi i pasojave të fatkeqësisë natyrore që ndodhin në një pjesë ose në të gjithë territorin e RSH. Referuar këtij akti normativ, Ndërtesë e dëmtuar është çdo ndërtesë publike private e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore që përbën rrezik përjetë e shëndetin e njerëzve dhe që nuk mund të riparohen..
- Me date 30.12.2019 del VKM nr. 886 ku Instituti të Ndërtimit i lihet si detyre kryesore inspektimi dhe vlerësimi i thelluar i dëmeve (pallate dhe shtëpi individuale) sipas listës bashkëngjitur këtij vendimi, ku pjesë e kësaj liste është dhe Bashkia Kurbin.
- Referuar kësaj liste, Instituti i Ndërtimit ngriti grupet e ekspertëve në terren dhe filloi punën në kryerjen e akt ekspertizave të godinave të dëmtuara nga tërmeti. Në datë 15.01.2020 doli VKM nr. 26 "Për kryerjen e akt ekspertizave në ndërtesat e dëmtuara " në të cilën përcaktohet e gjithë procedura që duhet të ndiqet në kryerjen e akt ekspertizës së thelluar..
- Referuar Aktit Normativ nr. 9 neni 4 pika 14 e saj thuhet: "Akt ekspertiza është akti që vërteton gjendjen e rrezikut për jetën dhe shëndetin nga ndërtesa apo grupi i ndërtesave të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, si dhe ku rekomandohen masat që duhen marrë sipas parashikimeve ligjore. Nga ana e Instituti të Ndërtimit u ngrit grupi i inspektimit dhe vlerësimit për kryerjen e akt ekspertizës të pallatit 84 rruga Gjimnazisti Laç.

- Ndërtesa Nr .84 në Rrugën "Gjimnazisti", është një godine me pese kate me strukture mbajtëse me muratorë të pa përforcuar me tulla silikate. Është një godine e cila është projektuar e ndërtuar në vitin 1976 dhe ndodhet në qytetin e Laçit. Pas vëzhgimeve të bëra nga grupi i inspektimit si dhe nga fotot që janë pjesë e akt ekspertizës shihet se ndërtesa ka pësuar dëme serioze strukturore, dhe disa dëmtime të moderuara deri në të rënda jo strukturore në katet e ulta, ndërsa katet e sipërme kane dëmtime me të lehta nga tërmeti. Nga inspektimi në terren janë vene re ndërhyrje strukturore në objekt, edhe pas ndërtimit të tij. Çarje të suvasë dhe plasaritje të mureve mbajtëse dhe ndarëse janë vërejtur në të. Referuar fotove të bëra në terren kemi çarje me kënd 45 grade në murin mbajtës të ndërtesës, plasaritje të suvatimeve me kënd 45 grade, dëmtime serioze të mureve mbajtës të ndërtesës. Për këtë objekt është realizuar dhe studimi gjeologë inxhinierik i zonës ku ndodhet pallati 84 si dhe u kryen prova laboratorike. Nga modelimi i objektit del se muratura nuk e përballon dot forcën prerëse maksimale nga veprimi sizmik pasi ka plasaritje të mëdha të cilat tregojnë për një humbje të madhe të aftësisë mbajtëse dhe rigjeditetit të strukturës.
- Për të përcaktuar karakteristikat fiziko-mekanike të truallit mbi te cilin ngrihet pallati, janë realizuar disa teste gjeoteknike. Sipas rezultateve të testeve të kryera (referuar Raporti gjeologo-inxhinierik), rezulton se themelet e ndërtesës Nr.84 mbështeten në depozitime të dobëta, për pasojë kjo e ka bërë strukturën vulnerabel gjatë tërmetit të 26 Nëntorit të vitit 2019. Muratura e pallatit nr. 84 (41) është pa breza e kolona antisizmike është një material kompozit i përbërë nga elementët rigidë dhe llaci lidhës. Zakonisht elementët rigidë janë prej guri ose prej tulle. Llaci përdoret për të bërë lidhjen midis elementëve. Në veprimin e ngarkesave vertikale të gravitetit dhe atyre horizontale të tërmetit, aftësia mbajtëse e nuraturës (si bashkim i elementëve kryesore dhe atyre lidhës) ndikohet nga rezistenca në shtypje, prerje, qëndrueshmëria, ujëthithja dhe zgjerimi termik. Siç shihet dhe nga fotot që janë pjesë përbërëse e akt ekspertizës, nga faktorë si cilësia e materialeve mosfunksionimi i diafragmaverigjide, punëtorja e pakualifikuar, ndërhyrjet strukturore në objekt pas ndërtimit të tij, moshja e madhe e objektit, dëmet më të rënda janë përqendruar kryesisht në katet e para dhe në katet e sipërme dallojmë dëme me të vogla.
- Në konkluzionet e dhëna nga Akt ekspertiza thuhet:
 - Godina nr.84 që ndodhet në qytetin e Kurbinit, është dëmtuar rëndë gjatë tërmetit të 26 Nëntorit 2019. Sistemi strukturor saj është me mure masive mbajtës, me tulla të plota silikate dhe është 5 kate e lartë. Godina është ndërtuar në vitin 1976. Kushtet ekzistuese të ndërtesës u vlerësuan bazuar në inspektimin e hollësishëm në vend të ndërtesës duke marrë parasysh kodet moderne të ndërtimit mbi sizmicitetin si EC-6 dhe EC-8.
 - Nga vëzhgimet dhe informacionet e marra nga banorët, u vërejt se godina ka pësuar dëme të rënda dhe është shpallur e pabanueshme. Gjithashtu zona në të cilën ndodhet godina është një nga zonat me sizmicitet të lartë të vendit, sipas hartës së riskut sizmik të vendit tonë.
 - Kjo strukturë me mure mbajtëse pa breza e kolona antisizmike, ka pësuar dëme jo vetëm jostrukturore por edhe dëme të rënda në strukturë nga tërmeti. Çarje dhe ndarje ndërmjet mureve mbajtës sidomos në qoshe të mureve mbajtës janë vërejtur për arsye si mosfunksionim siç duhet i diafragmave rigjide, cilësia e dobët e ndërtimit dhe punëtorja e pa kualifikuar, ndërhyrjet e bëra në strukturë pas ndërtimit të saj, mangësitë e kodit të

ndërtimit të kohës, gjithmonë nëse është aplikuar, mungesa e mirëmbajtjes dhe riparimit joadekuat pas ngjarjeve të mëparshme dëmtuese sizmike.

-Gjatë tërmetit me magnituditë $M=6.4$ të nëntorit 2019, shkatërrimi i llacit, puna jashtë planit e mureve mbajtës dhe çarjet nga forca prerëse janë shkaktuar në pjesë të ndryshme të strukturës, duke sjellë dëme të rënda në të.

-Si konkluzion, në tërmetin me magnituditë 6.4 të nëntorit 2019, shkatërrimi i llacit, puna jashtë planit të mureve mbajtës nga përdredhja dhe çarjet e shkaktuara nga forcat prerëse kanë shkaktuar dëme të rënda.

- Sidoqoftë, ky tërmet është dukshëm më i vogël se tërmeti i projektimit sipas Eurokodit 8. Duke marrë parasysh statusin aktual të dëmtimit të ndërtesës, si dhe rezultatet testimeve laboratorike dhe studimit gjeologo-inxhinierik, riparimi i ndërtesës mund të jetë i kushtueshëm dhe rrjedhimisht jo-efikas, sipas mendimit të ekipit tonë. Në këto kushte do të rekomandonim prishjen e kësaj godine.
- Në arsyetimin e gjykatës është vlerësuar se njoftimi për shembjen e pallatit nr. 84 ne Lagjen 3 Kurbin, në thelb është një veprim administrativ i organit publik që nuk plotëson kushtet për të qënë akt administrativ apo kontratë dhe që krijon pasoja juridike mbi të drejtën subjektive apo interesat e ligjshme të palës paditëse.
- Neni 41 i K.Pr.A, përcakton mënyrën e fillimit të një procedure administrative ku në pikën 2 të saj thuhet se, kjo procedurë administrative fillon kryesisht dhe nga organi publik, ku thuhet se "Situata faktike është e tillë që organi publik duhet të fillojë procedurën për mbrojtjen e interesit publik. Si më lart cituar, si pasoje e tërmetit të datës 26.11.2019 nga ana e Qeverisë Shqiptare u morën disa masa emergjente. Me datë 27.11.2019 doli VKM nr. 750 "Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore në qytetet Durrës Tirane" i ndryshuar, nga konstatimet paraprake që i janë bërë pallatit nr. 84 në Kurbin del se ky pallat ishte i pabanueshëm dhe e kishte të nevojshme kryerjen e akt ekspertizës së thelluar.
- Nga ana e Institutit të Ndërtimit referuar dhe VKM nr. 886/2019 u morën masa për kryerjen e akt ekspertizës së këtij pallati, ku në përfundim doli që pallati është i pabanneshëm Kjo bëhej për mbrojtjen civile me qellim parandalimin dhe mënjanimin e pasojave të mëtejshme që mund të vinin.
- Referuar Gjykatës, Vendimi i marrë nga Këshilli Bashkiak i Kurbin për demolimin e objektit është i paligjshëm, dhe Gjykata në arsyetimin e tij bazohet në nenin 109 të K.Pr.Administrative. Ndërkohë që Akti Normativ nr. 9/2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore" neni 12 i saj thotë se autoritetet përgjegjëse për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore janë d) Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në rastin tonë Bashkia Kurbin.
- Referuar dhe Aktit Normativ nr. 9/2019 organi që duhet të marrë vendimin, duke u bazuar dhe në Akt Ekspertizën e Thelluar të Pallatit nr. 84 është Këshilli Bashkiak i Bashkisë Kurbin.
- Po ti referohemi pikës 2 dhe 3 të nenit 35 të aktit normativ nr. 9/2019 janë të përcaktuara se prishja e objekteve si publike dhe private bëhet me miratim të organit shtetëror pronar për ndërtesat publike, ndërkohë që për ndërtesat private bëhet me vendim të njësisë së qeverisjes vendore në territorin e të cilës ndodhet banesa. Pra siç dhe shikojmë në bazë të provave nuk kemi të bëjmë me një akt administrativ të paligjshëm, pasi ky akt është marrë në përputhje të plotë me ligjin.

- Ne lidhje me më shfuqizimin e aktit të ekspertimit të bërë nga pala e paditur Instituti i Ndërtimit si dhe kryerjen e vlerësimit të kostos së ndërtimit dhe kostos së riparimit të pallatit nr. 84 lagjia 3 Laç, Instituti i Ndërtimit e kundërshton si më poshtë vijon:
- Akti i ekspertizës së godinës në fjalë është akt i plotë dhe është hartuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit dhe eurokodeve në fuqi, ashtu sikur dhe parashtruar dhe më sipër ku janë dhënë në mënyrë të detajuar fotot provat laboratorike studimi gjeologjik. Referuar dhe Aktit Normativ nr. 9 neni 4 pika 14 e tij, kuptohet se, Akti Ekspertiza është akti që vërteton gjendjen e rrezikut për jetën dhe shëndetin nga ndërtesa apo grupi i ndërtesave të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, si dhe ku rekomandohen masat që duhen marrë sipas parashikimeve ligjore. Në aktin e ekspertizës të ndërtesës nr. 84 në qytetin e Laçit, të hartuar nga inxhinieret e Institutit të Ndërtimit, janë përcaktuar në mënyrë të detajuar rekomandimet dhe masat që duhet të merren referuar KTP dhe Eurokodeve në fuqi.
- Akti ekspertiza e pallatit nr. 84 në Laç Kurbin është i ligjshëm, pasi është nxjerrë nga një organ publik kompetent, siç është Instituti i Ndërtimit referuar VKM nr. 886/2019 (ku Institutit të Ndërtimit i është dhënë kompetenca për kryerjen e inspektimit dhe vlerësimit të objekteve të dëmtuara nga tërmeti) si dhe në përputhje me Aktin Normativ nr. 9/2019 dhe me VKM nr. 26/2020.
- Një akt ekspertizë e kryer nga një institucion brenda kompetencave të tij nga inxhinierë të licensuar si dhe në përputhje me procedurat ligjore të përcaktuara në Aktin Normativ Nr.9/2019 si dhe në VKM nr. 26/2020; mund të rrëzohet dhe të shfuqizohet vetëm më një akt ekspertizë tjetër të kryer nga inxhinierë të licensuar dhe të caktuar nga Gjykata.
- Nga ana e Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative, është marrë si prove një akt ekspertizë e kryer privatisht nga pala paditëse nga inxhinierë të licensuar nga Instituti i ndërtimit ndërsa caktimi i ekspertëve nuk është bërë nga Gjykata dhe emërimi i ekspertit nuk i është bërë e ditur sekretarit gjyqësor. Pra referuar dhe bazës ligjore në fuqi ky akt ekspertizë është e pavlefshme pasi nga ana e Gjykatës nuk janë respektuar pikat kryesore të nenit 225 të Kodit të Procedurës Civile.
- B) Në lidhje me pikën e Vendimit për detyrimin e Institutit të Ndërtimit të koston së riparim dhe rindërtimit të Pallatit 84 në Kurbin, Instituti i Ndërtimit e kundërshton referuar pikës 7 e kësaj VKM dhe pretendon se referuar kësaj pike Instituti i Ndërtimit ka si detyre vetëm kryerjen e akt ekspertizës ku jepen dhe rekomandimet përkatëse ose siç e quajmë, detyre projektimi referuar VKM nr. 354/2015. Subjektet që do të merren me hartimet e projekt preventivave (përcaktimin e kostos së ndërtimit ose të riparimit) rehabilituese do të bazohet në këtë akt ekspertizë (detyre projektimi).
- Referuar nenit 34/3 dhe 35 të aktit normativ nr.9/2019, vlerësohet se në rastin konkret Akti ekspertiza për pallatin 84 në Kurbin, referuar dhe mendimit të eksperteve, rekomandon demolimin (prishjen) e objektit pasi riparimi i këtij objekti kushton më shumë se kryerja e ndërtimit nga e para, pasi tejkalon 70% e vlerës së rikonstruksionit, duke dhënë dhe konkluzionet përkatëse në këtë akt ekspertizë.
- Instituti i Ndërtimit ka të drejtë, referuar dhe bazës ligjore në fuqi, kryerjen e akt ekspertizës. Ndërkohë referuar VKM nr. 26/2020 pika 7 e saj, të drejtën për kryerjen e projektit preventiv të rehabilitimit të objektit (Pallati 84 Kurbin) e kanë Inxhinierë të Licensuar në fushën e ndërtimit, ku si pikë kryesore në license duhet të kenë pikën 3.d. Është ky projekt preventiv i rehabilitimit i cili së bashku me studimin gjeologjik të zonës akt ekspertizën etj, i dërgohet Institutit të Ndërtimit (referuar pikës 3,4 të nenit 34 të Aktit

Normativ nr.9/2019) për kryerjen e opionencës teknike. Kryerja njëkohësisht e akt ekspertizës së një objekti, projektit preventiv (përcaktimit të kostos së riparimit)si dhe opionencës teknike nga ana e të njëjtit Institucion do të bënte që të ishim në kushtet e konfliktit të interesit, pasi i njëjti institucion nuk mund të kryente dhe akt ekspertizë dhe projekt (përcaktimin e kostos së riparimit) e të njëjtit objekt dhe të realizonte opionencën teknike për të parë nëse ky objekt është kryer në përputhje me kushtet teknike të projektimit dhe Eurokodet në fuqi

- Pra duke ju referuar dhe bazën ligjore në fuqi Instituti i Ndërtimit nuk e ka si detyrim ligjor kryerjen e kostos së riparimit të Pallatit nr. 84 në Kurbin, por e kryejnë inxhinierët e licensuar me license në projektim ku të ketë dhe piken 3d, referuar Kushteve Teknike të Projektimit dhe Eurokodeve në Fuqi.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim, pala e paditur Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë Bashkisë Kurbin, i cili ka kërkuar prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes, duke parashtruar këto shkaqe:

- Në Bashkinë Kurbin, nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019 u dëmtuan një sërë banesash kolektive dhe individuale, përfshirë edhe pallatin nr.84, lagjia nr.3, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin.
- Për këtë pallat janë mbajtur 3 Akt-konstatime (për tre shkallët) me datë 06.12.2019, sipas të cilëve gjendja e ndërtimit të pabanueshëm. Instituti i Ndërtimit (me cilësinë e palës së paditur në gjykim), bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 886, datë 30.12.2019 "Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2019, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019" ka kryer ndër të tjera edhe Akt-ekspertizën e thelluar për pallatin nr. 84, ku si përfundim është konkluduar si më poshtë: "*Konkluzioni Si përfundim, mund të konkludojmë që kjo ndërtesë nuk ka aftësi mbajtëse të përballojë jo vetëm ngarkesat dinamike sizmike, por as ato statike. Objekti nuk ka elementet minimale antisizmike sikurse janë brezat lidhet monolitizues dhe koloncinat antisizmike. Soletat janë të para përgatitura me monolitizim pothuajse inegzistent duke mos ofruar efektin e diafragmës horizontale në ndërtesën ekzistuese. Referuar analizës së mësipërme kompjuterike dhe inspektimit në terren, duke vlerësuar të gjitha faktorët e aftësisë mbajtëse për ngarkesa statike dhe dinamike arrijmë në konkluzionin që objekti nuk plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë. Objekti përbën rrezik për jetën e banorëve. Rekomandimi ynë është që ndërtesa të prishet pasi restaurimi dhe përforcimi i saj nuk do të ishin të justifikuara nga ana ekonomike".*
- Së pari, Gjykata ka cituar në vendim se: Akti i ekspertimit nuk ka asnjë përlllogaritje të vlerës së kostos së ndërtimit dhe vlerës së kostos së riparimit. Po ti referohemi përmbajtjes së akt ekspertizës së thelluar, duke vlerësuar të gjitha faktorët e aftësisë mbajtëse për ngarkesa statike dhe dinamike arrijmë në konkluzionin që objekti nuk plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë, pra rrjedhimisht nuk ka qenë e nevojshme përlllogaritja e kostos përderisa objekti nuk plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë.
- Së dyti, Gjykata në arsyetimin e vendimit, ka vlerësuar se Bashkia Kurbin, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.63, datë 22.04.2020 ka vendosur: miratimin e prishjes së detyruar

të ndërtesave prona publike dhe private, të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, bazuar në akt-ekspertizat e thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tiranë ndër të qilat është dhe, pallati 84. Ndërkohë, që sipas gjykatës aktekspertiza është dërguar pranë Bashkisë Kurbin me shkresën nr.1244, prot, datë 03.06.2020. Gjykata duke mbajtur qëndrim haptazi të njëanshëm në favorin e palës paditëse, nuk i ka shqyrtuar provat e paraqitura sepse sipas V.K.B-së Nr.63, datë 22.04.2020 aktekspertiza është dërguar me datë 02.03.2020, kjo citohet dhe në VKB dhe jo me datë 03.06.2020. Pra rrjedhimisht është sjellë aktekspertiza dhe pastaj është marrë Vendimi i Këshillit Bashkiak.

- Pas ankesës së paditësave është kërkuar një riekspertizë e cila ka ardhur në datën që citon gjykata në vendim. Në dosje gjeni Vendimin e Këshillit Bashkiak që e vërteton këtë fakt, që është administruar në dosjen gjyqësore.
- Së treti, Gjykata ka argumentuar se procedura administrative nuk është kryer nga pala e paditur në pajtim të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore". Ky pretendim nuk qëndron, në Bashkinë Kurbin nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, u dëmtuan një sërë banesash kolektive dhe individuale, përfshirë edhe pallatin nr.84, lagjia nr.3, Njesia Administrative Laç, Bashkia Kurbin.
- Për këtë pallat siç e cituam edhe më lart, janë mbajtur 3 (tre) Akt-konstatime (për tre shkallët) me datë 06.12.2019, sipas të cilëve gjendja e ndërtimit të pabanueshëm.
- Instituti i Ndërtimit bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 886, datë 30.12.2019 "Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2019, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019" ka kryer ndër të tjera edhe Aktekspertizën e thelluar për pallatin nr. 84, ku si përfundim është konkluduar që ndërtesa të prishet pasi restaurimi dhe përforcimi i saj nuk do të ishin të justifikuara nga ana ekonomike.
- Këshilli Bashkiak, i Bashkisë Kurbin, në mbështetje të nenit 113, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nën pika 1, shkronja "b", të nenit 29, pika 1, të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ligjit nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", të neneve 34 dhe 35 të ligjit nr. 97/2019 "Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019, "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë", të ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.886, datë 30.12.2019 "Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2019, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 10, datë 10.1.2020 "Për një shtesë fondi në buxhetin vitit 2020, miratuar për Bashkinë Tiranë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019", si dhe të shkresës së Institutit të Ndërtimit Tiranë nr.647 prot, datë 02.03.2020 "Dërgim Aktekspertizë e thelluar", me vendimin nr. 63, datë 22.04.2020 vendosi miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, bazuar në Aktekspertizat e thelluara të kryera nga Instituti i

Ndërtimit Tiranë, ku përfshihet edhe pallati nr. 84, vendim ky i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë me shkresën nr.321/2 prot, datë 23.04.2020 "Konfirmim vendimi".

- Pas ankesave të banorëve të Pallatit nr.84, Bashkia Kurbin me shkresën nr.1652/1 prot, datë 29.04.2020 "Kërkesë për shqyrtimin e kërkesës së banorëve të Pallatit nr.84, Lagjia nr.3, Laç", iu drejtua Institutit të Ndërtimit Tiranë me kërkesën për riekspertizë të pallatit nr.84. Bazuar në VKM nr .886, datë 30.12.2019 "Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për Vitin 2019, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019" Institutit i lihet si detyrë kryesore inspektimi dhe vlerësimi i thelluar i dëmeve (pallate dhe shtëpi individuale).
- Me shkresën nr.1244 prot, datë 03.06.2020, protokolluar pranë Bashkisë Kurbin, me nr.2433 prot, datë 17.06.2020 "Dërgim akt ekspertize mbi performancën strukturore të ndërtesës nr.84, është aritur në konkluzionin se "...Në këto kushte do të rekomandonim prishjen e kësaj godine". Pala paditëse në kërkesëpadi është shprehur ndër të tjera se: ". Në lidhje me këtë përfundim, Bashkia Kurbin ka bërë me dije të 37 familjet e pallatit me njoftimin për "Kjo godinë është shpallur e pabanueshme, ju lutemi të evakuoni banesat deri në një njoftim të dytë", sipas tekstit "*Bashkia Kurbin, njofton banorët e Pallatit nr.84, se në aktekspertizën e thelluar të kryer nga Instituti i Ndërtimit Tiranë rekomandohet që Pallati nr.84, i dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019 të priset.*". Banorët e këtij pallati pas njoftimeve nga ana e Bashkisë kanë çmontuar dyer dhe dritare dhe kane boshatisur apartamentet e tyre duke hequr të gjitha materialet që ndodheshin në këto apartamente.
- Këshilli Bashkiak, me vendimin nr. 63, datë 22.04.2020 "Për miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, bazuar në aktekspertizat e thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tiranë" ka vendosur ndër të tjera edhe prishjen e detyruar të Pallatit nr. 84, Njësia Administrative Lac.
- Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.65, datë 29.01.2020 "Per shpalljen e zonës së re për zhvillim në Njësinë Administrative Laç Bashkia Kurbin dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese", është vendosur shpallja si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, Zona 1/2, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin, zonë e re për zhvillim, zone ku ndodhet edhe Pallati nr.84.
- Përsa i përket akt-ekspertizës së kryer në mënyrë private nga pala paditëse, e cila u mor si provë dhe u pranua nga Gjykata, ashtu siç jemi shprehur dhe në seancën gjyqësore nuk kemi qenë dakord që të merrej si provë, pasi eksperti duhet të ishte caktuar nga Gjykata ashtu siç parashikohet në nenin 224/a të ligjit nr. 8116, datë 29.3.1996 "Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar,
- Pra gjykata ka hedhur poshtë dy herë mendimin e Institutit të Ndërtimit, i cili është një institucion publik në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ka si objekt kryesor të punës së saj. Gjykata, ka lejuar palën paditëse, që të paraqesë në gjykim një akt ekspertimi të kryer nga një ekspert vlerësues privat, i cili kurrsesi nuk mund të konsiderohet si provë, pasi nuk është marrë në formën e duhur ligjore, gjykata duhet që ta thërriste këtë ekspert për të deklaruar përpara gjykatës, por jo të merrte si provë këtë akt ekspertimi, dhe të dilte në një konkluzion të gabuar në bazë të një akti ekspertimi privat.

- Gjykata në rast se do e kishte shqyrtuar çështjen në themel, duhej të kishte caktuar një grup ekspertësh vlerësues, sipas nenit 224/a e vijues të K.Pr.Civile, ndonëse gjatë gjithë gjykimit i është kërkuar gjykatës nga ana e përfaqësueses ligjore të Bashkisë Kurbin. Gjykata e ka pranuar të plotë padinë e palës paditëse, madje duke e konstatuar të paligjshëm veprimin juridik njoftim për shembjen e pallatit nr. 84 të nxjerre nga Bashkia Kurbin. Por gjykata nuk arsyeton se ku Bashkia Kurbin e ka nxjerrë aktin njoftim prishje pallati nr. 84 të paligjshëm, akti i cili është konfirmuar edhe nga Prefekti i Qarkut Lezhë. Që një akt apo veprim juridik të jetë absolutisht i pavlefshëm duhet të bie në kundërshtim flagrant me ligjin dhe të jetë nxjerrë nga një organ jo kompetent dhe i pa identifikuar sipas nenit 108 të K.Pr.Administrative Akt-ekspertiza e bërë nga Instituti i Ndërtimit, mund të kundërshtohet dhe jo të shfuqizohet, pasi akti është bërë dy herë nga kjo e fundit, në bazë të ankesës së bërë nga paditësit në këtë gjykim drejtuar Institutit të Ndërtimit.
- Gjithashtu, gjykata ka detyruar Bashkinë Kurbin, si palë e paditur në gjykim të riparojë pallatin nr. 84. Edhe në këtë pikë gjykata ka gabuar rëndë, pasi pala e paditur Bashkia Kurbin, nuk është kompetente për rindërtimin e pallateve por në bazë të VKM nr. 65, datë 29.01.2020 " Për shpalljen e zonës së re për zhvillim në njësinë Administrative Laç, Bashkia Kurbin dhe caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese" njësi zbatuese është Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të cilin Gjykata duhet ta kishte thirrur si palë në gjykim, por ka lejuar vazhdimin e shkeljeve procedurale.
- Bazuar në VKM nr.886, datë 30.12.2019 "Për një shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2019, për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019 Institutit të Ndërtimit i lihet si detyrë kryesore inspektimi dhe vlerësimi i thelluar i dëmeve (pallate dhe shtëpi individuale). Pra, si përfundim Gjykata ka gabuar në pranimin e akt-ekspertizës së kryer në mënyrë private nga pala paditëse.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim, Avokatura e Shtetit pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë, duke parashtruar këto shkaqe:

- Siç ka rezultuar dhe gjat gjykimit, nga ana e Institutit të Ndërtimit nga grupi i inspektimit është kryer akt ekspertiza e pallatit 84, rruga Gjimnazisti, Laç. Pas vëzhgimeve të kryera u vërejt se në ndërtesë ka dëme serioze strukturore si dhe dëmtime të moderuara deri në të rënda jostrukturore në katet e ulëta, ndërsa katet e sipërme kanë dëme më të lehta nga tërmeti.
- Nëpërmjet shkresës nr. 1244 datë 03.06.2020 është dërguar akt ekspertiza e thelluar pranë Bashkisë Kurbin ku ndër të tjera në pikën 3 të konkluzioneve theksohet se: Duke marrë parasysh statusin aktual të dëmtimit të ndërtesës si dhe rezultatet e testimeve laboratorike dhe studimin gjeologjik-inxhinierik, riparimi i ndërtesës mund të jetë i kushtueshëm dhe rrjedhimisht jo efikas. Në këto kushte do të rekomandonim prishjen e godinës.
- Nga inspektimi në terren janë vërejtur ndërhyrje strukturore në objekt dhe pas ndërtimit të tij që konstatonin në çarje të suvasë, plasaritje të mureve mbajtëse dhe ndarëse. Nga ana e të paditurit është realizuar edhe studimi gjeologjik inxhinierik si dhe u kryen edhe provat laboratorike. Janë kryer disa teste për të përcaktuar karakteristikat fiziko-mekanike dhe Sipas këtyre rezultateve arihet në përfundimin se themelet e ndërtesës mbështeten në

dhera të dobët e për pasojë e ka bërë strukturën vunerabël gjatë tërmetit të 26 nëntorit 2019. Akti ekspertizë përcakton qartë se kjo godinë është dëmtuar rëndë nga tërmeti i 26 nëntorit si dhe zona në të cilën ndodhet ndërtesa është me sizmicitet të lartë të vendit sipas hartës së riskut sizmik të vendit tonë.

- Hartimi i këtij akti ekspertizë është bazuar në Eurokode 8, kushtet teknike dhe aktet ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi në RSH. Akti i ekspertizës i kryer nga i padituri është një akt i plotë dhe hartuar në të gjithë elementët e saj në baze të gjithë kushtet teknike të projektimit dhe eurokodeve në fuqi. Ky akt ekspertizë vërteton gjendjen e rrezikut për jetën dhe shëndetin e banorëve si dhe u rekomandohet të merren masa sipas parashikimeve ligjore, masa këto të sqaruara në akt ekspertizë.
- Akti administrativ i Institutit të Ndërtimit është i ligjshëm në saj të hartimit të tij në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Ky akt është kryer në zbatim të detyrave funksionale sipas VKM 886/2019 dhe referuar aktit normativ nr. 9/2019. Ky akt në zbatim të gjithë legjislationit në fuqi është një akti i cili rekomandime apo detyrë projektimi sipas VKM 354/2015.
- Pala paditëse pretendon se nuk ka rrezik për ta dhe se nga Bashkia Kurbin nuk është marrë asnjë masë lidhur me parandalimin e rrezikut. Por siç u vërtetua nga Bashkia Kurbin të gjithë banorët që kanë paraqitur kërkesë për trajtim me qera dhe kanë plotësuar dokumentacionin e nevojshëm trajtohen në vazhdimësi me bonus qiraje 37 familje, që do të thotë se paditësit kanë pranuar faktin e gjendjes kritike të objektit.
- Të gjithë banorët janë njoftuar për rrezikshmërinë dhe gjendjen e godinës në të cilën në hyrje të tij është edhe shënimi rrezik. Kjo godinë është shpallur e pabanueshme dhe që në momentin që banorët trajtohen me bonus qiraje duhet të evakoheshin nga godina deri në një njoftim të dytë.
- Pas njoftimit të dytë banorët kanë çmontuar dyer dritare dhe kanë braktisur apartamentet duke hequr të gjitha materialet dhe janë evakuar nga banesat e tyre. Pala paditëse pretendon se të paditurit nuk depozituan asnjë provë që të vërtetojë se objekti ka rrezik shembje si pasojë e tërmetit të 26 nëntorit 2019. Të gjitha aktet të cilat i kundërshton pala paditëse janë prova të cilat kanë vënë në dijeni paditësit për rrezikun që ka ky objekt. Pretendimet e paditësve janë sqaruar në akt ekspertizë e cila vërteton gjendjen e rrezikut për jetën dhe shëndetin e banorëve si dhe u rekomandohet të merren masa sipas parashikimeve ligjore, masa këto të sqaruara në akt ekspertizë. Këto masa janë vënë në zbatim nga Bashkia Kurbin.
- Palët paditëse janë sqaruar dhe informuar se do të përfitojnë nga procesi i rindërtimit sipas parashikimeve ligjore.
- Gjykata në mënyrë të gabuar ka vlerësuar se të paditurit kanë kryer shkelje të procedurës së nevojshme të verifikimit, vlerësimit, dhe rishikimit të vendimit të shembjes së godinës. Palët e paditura kanë respektuar procedurat ligjore dhe aktet e nxjerra nuk mund të konsiderohen të paligjshme për faktin e pretendimit se akti i thelluar mban një datë të mëvonshme se akti i miratimit të tij nga i padituri Bashkia Kurbin.
- Akti i thelluar nga i padituri Instituti i Ndërtimit sqaron dhe thekson të gjitha rreziqet e objektit. Ky akt nëse nuk do të ishte marrë në konsideratë nga paditësit, këta të fundit nuk do të ishin pjesë e bonusit të qerasë dhe as nuk do të ishin evakuar nga banesat e tyre.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

pasi dëgjoi relatimin e çështjes nga gjyqtari kryesues Enkelejdja Metaliaj (Softa), referuar akteve bashkëngjitur dosjes Nr. 13522/12894, Dt. 27.01.2021 si dhe verifikoi kushtet e pranueshmërisë së ankimit,

VEREN

I. Rrethanat e çështjes:

Nga aktet e depozituara në dosjen gjyqësore evidentohet se, paditësi: Ylli Tuga, Gjok Çoba, Shëfqet Basha dhe Arjan Çoba, janë banorë të qytetit të Laçit dhe kanë në pronësi pasuri të paluajtshme të llojit "apartamente dhe njësi shërbimi" të cilat ndodhen në pallatin nr. 84, Zona Kadastrale 2363, në Lagjen Nr.3, Laç, Kurbin.

Si pasoje e lëkundjeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, pallati i paditësve, ka pësuar dëmtime, me shkresën nr. 2456/1 prot, datë 19.06.2020, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit, Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Kurbin i ka kthyer përgjigje Kërkesës me nr. 2456 prot, datë 19.06.2020 të njërit prej paditësve. z. Gjok Çoba, duke i bere me dije se:

"Duke u bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë mbi Fatkeqësitë Natyrore, Këshilli i Ministrave ka shpallur gjendjen e Fatkeqësisë Natyrore për Qarkun e Lezhës dhe ka ngritur Qendrën Operacionale të Emergjencave Lezhë për menaxhimin, koordinimin dhe bashkërendimin e veprimeve të Institucioneve Shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe kapërcimin e dëmeve dhe pasojave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019. Qendra Operacionale e Emergjencave Lezhe në zbatim të kompetencave të përcaktuara nga ligji nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile" ka ngritur grupet e inspektimit vizual nga profesionistët e fushës së ndërtimit, dhe konkretisht duke thirrur në detyrë Inxhinierë të të gjitha Qarqeve të Veriut të Shqipërisë që punojnë nëpër Institucionet Shtetërore.

Grupet e inspektimit vizual u urdhëruan dhe u instruktuan në bazë të legjislacionit në fuqi që të kryejnë Akt Konstatimi Vizual në çdo objektit në territorin që mbulon Qarku i Lezhës, duke filluar me godinat kolektive Institucionet Shtetërore dhe me pas me banesat private.

Konkretisht më datë 06.12.2019 Grupi i Inxhinierave kreu Akt Konstatimin Vizual duke arritur në konkluzionin: "Pallati Nr. 84 Lagje Nr.3 Laç Kurbin, objekt me dëmtime të mesme dhe i pabambueshëm në të tre shkallet e tij deri në Aktin e Analizës së thelluar nga Instituti i Ndërtimit".

Në bazë të VKM nr. 10, datë 10.01.2020 "Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020, miratuar për Bashkinë Tiranë dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për përballimin e shpenzimeve për inspektimin dhe vlerësimin e dëmeve në njësitë e vetëqeverisjes vendore të prekura nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26.11.2019" si dhe Vendimi Nr. 26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e Akt Ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara", Instituti i Ndërtimit ka kryer Akt Ekspertizën e Thelluar ku ndër të tjera ka arritur në konkluzionin si vijon: "Si përfundim, mund të konkludojmë që ljo ndërtesë nuk ka aftësi mbajtëse të përballojë jo vetëm ngarkesat dinamike sizmike, por as ato statike. Objekti nuk ka elementet minimale antisizmike sikurse janë brezat lidhet monolitizues dhe koloncinat antisizmike. Soletat janë të parapregatitura me monolitizim pothuajse inegzistent duke mos ofruar efektin e diafragmës horizontale në ndërtesën ekzistues. Referuar analizës së mësipërme kompjuterike dhe inspektimit ne terren, duke vlerësuar të gjitha faktorët e aftësisë mbajtëse për ngarkesa statike dhe dinamike arrijmë në konkluzionin që objekti nuk plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë. Objekti

përbën rrezik për jetën e banoreve. Rekomandimi ynë është që ndërtesa të prishet pasi restaurimi dhe përforcimi i saj nuk do të ishin të justifikuar nga ana ekonomike. ”.

Me propozimin e Kryetares së Bashkisë Kurbin nisur nga Shkresa me nr. 647 prot, datë 02.03.2020 ardhur nga Instituti i Ndërtimit, Këshilli Bashkiak Kurbin me Vendimin Nr.63, datë 22.04.2020 “Për miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, bazuar në Akt ekspertizat e thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tirane” vendosi: “Miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 bazuar në Akt ekspertizat e thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tirane ndër të cilat është edhe Pallati 84 Njësia Administrative Laç Lagje Nr. 3”.

Pas ankesave të banoreve të pallatit nr.84, Bashkia Kurbin me shkresën Nr. 1652/1, datë 29.04.2020 “Kërkesë për shqyrtimin e kërkesës së banoreve të pallatit nr. 84, lagja Nr 3, Njësia Administrative Laç, Bashkia Kurbin” i është drejtuar Institutit të Ndërtimit Tirane me kërkesën për ri ekspertizë të pallatit Nr.84.

Me shkresën Nr. 1244 prot, datë 03.06.2020 protokolluar pranë Bashkisë Kurbin me Nr. 2433 prot, date 17.06.2020, Instituti i Ndërtimit ka përcjellë aktin “Dërgim akt ekspertize të thelluar për ndërtesën nr 84” ku në pikën 3 “konkluzione” citohet se:

“Godina nr. 84 që ndodhet në qytetin e Kurbin, është dëmtuar rëndë gjatë tërmetit të 26 Nëntorit 2019. Sistemi strukturor saj është me mure masive mbajtës, me tulla të plota silikate dhe është 5 kate e lartë. Godina është ndërtuar në vitin 1976. Kushtet ekzistuese të ndërtesës u vlerësuan bazuar në inspektimin e hollësishtëm në vend të ndërtesës duke marrë parasysh kodet moderne të ndërtimit mbi sizmicitetin si EC-6 dhe EC-8.

Nga vëzhgimet dhe informacionet e marra nga banorët, u vërejt se godina ka pësuar dëme të rënda dhe është shpallur e pabanueshme. Gjithashtu zona në të cilën ndodhet godina është një nga zonat me sizmicitet të lartë të vendit, sipas hartës së riskut sizmik të vendit tonë.

Kjo strukturë me mure mbajtëse pa breza e kolona antisizmike, ka pësuar dëme jo vetëm jostrukturorë por edhe dëme të rënda në strukturë nga tërmeti. Çarje dhe ndarje ndërmjet mureve mbajtës sidomos në qoshe të mureve mbajtës janë vërejtur për arsye si mosfunksionim siç duhet i diafragmave rigjide, cilësia e dobët e ndërtimit dhe punëtoria e pa kualifikuar, ndërhyrjet e bëra në strukturë pas ndërtimit të saj, mangësitë e kodit të ndërtimit të kohës, gjithmonë nëse është aplikuar, mungesa e mirëmbajtjes dhe riparimit joadekuat pas ngjarjeve të mëparshme dëmtuese sizmike.

Gjatë tërmetit me magnitudë $M=6.4$ të nëntorit 2019, shkatërrimi i llaçit, puna jashtë planit e mureve mbajtës dhe çarjet nga forca prerëse janë shkaktuar në pjesë të ndryshme të strukturës, duke sjellë dëme të rënda në të.

Si konkluzion, në tërmetin me magnitudë 6.4 të nëntorit 2019, shkatërrimi i llaçit, puna jashtë planit të mureve mbajtës nga përdredhja dhe çarjet e shkaktuara nga forcat prerëse kanë shkaktuar dëme të rënda. Sidoqoftë, ky termet është dukshëm me i vogël se tërmeti i projektimit sipas Eurokodit 8. Duke marrë parasysh statusin aktual të dëmtimit të ndërtesës, si dhe rezultatet e testeve laboratorike dhe studimit gjeologo-inxhinjërrik, riparimi i ndërtesës mund të jetë i kushtueshëm dhe rrjedhimisht jo efikas, Në këto kushte do të rekomandonim prishjen e kësaj godine”.

Me vendimin nr. 63, datë 22.04.2020 "Për miratimin e prishjes së detyrueshme të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, bazuar në aktekspertimin e thelluar të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, ka vendosur: "Miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.2019, bazuar në Aktekspertizat e thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, për ndërtesa prona publike dhe private, sipas listës bashkangjitur vendimit.... Si përfundim, mund të konkludojmë që kjo ndërtesë nuk ka aftësi mbajtëse të përballojë jo vetëm ngarkesat dinamike sizmike, por as ato statike. Objekti nuk ka elementet minimale antisizmike sikurse janë brezat lidhet monolitizues dhe koloncinat antisizmike. Soletat janë të para përgatitura me monolitizim pothuajse inegzistent duke mos ofruar efektin e diafragmes horizontale në ndërtesën ekzistuese. Referuar analizës së mësipërme kompjuterike dhe inspektimit në terren, duke vlerësuar të gjitha faktorët e aftësisë mbajtëse për ngarkesa statike dhe dinamike arrijmë në konkluzionin që objekti nuk plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë. Objekti përbën rrezik për jetën e banorëve. Rekomandimi ynë është që ndërtesa të prishet pasi restaurimi dhe përforcimi i saj nuk do të ishin të justifikuar nga ana ekonomike".

Pas kësaj palët paditëse, janë njohur me Njoftimin e datës 18.06.2020 të Bashkisë Kurbin për prishjen e detyruar të pallatit, e cila do të ekzekutohet jo më parë se 10 dite kalendarike nga momenti i shpalljes së këtij njoftimi.

Nga aktet e depozituara në dosjen gjyqësore, evidentohet të jetë paraqitur në cilësinë e provës dhe akti i ekspertimit të kryer nga subjekti privat Altea Geostudio 2000, në lidhje me objektin e gjykimit, nga ku është arritur në përfundimin se: "... Nga të dhënat e studimit gjeologo - inxhinierike rezulton se, themeli i pallatit nr. 84, në qytetin e Laçit është i mbështetur mbi depozitime të dobta, kjo ka bërë që pallati të mos i rezistojë tërmetit të datës 26.11.2019. Nëqoftëse do të ndërtohet një pallat i ri rekomandojmë që si mënyrë themelimi të përdoren themele të thella të mbështetura në shtresën e depozitimeve të Neogjenit ose themele të cekta, por duke e përmirësuar tokën natyrore me një shtresë artificiale me material granular zhavorr ose shkëm i thyer. Shtresa artificiale duhet të ngjeshët deri në 98% e ngjeshjes në laborator. Por para ndërtimit të pallatit të ri duhet të kryhet një studim i detajuar gjeologo inxhinierike. Rekomandojmë që materialet që do të përdoren të jenë me granulometri të rregullt 0-70mm dhe treguesi i plasticitetit të jetë më i madh se 5 dhe CBR më e madhe se 40%."

Sipas vlerësimit të kryer tekniko ekonomik të hartuar nga eksperti inxhinier konstruktiv Fatmir Nuhaj është arritur në përfundimin se: "Vlera e rindërtimit të objektit është 118.753.874 lekë të reja, ndërsa vlera e përforcimit është 40.681.451 lekë të reja, e thënë ndryshe sa 34% e vlerës së rindërtimit."

Ylli Tuga, Gjok Çoba, Shëfqet Basha dhe Arjan Çoba duke mos qënë dakord me njoftimin e kryer kanë paraqitur për gjykim kërkesën me objekt "Sigurim padie dhe caktimin e masës së sigurimit, pezullim të ekzekutimit të Aktit të Ekspertimit të Institutit të ndërtimit, si dhe pezullimin e të gjitha veprimeve nga ana e Bashkisë Kurbin për prishjen e pallatit 84, lagja nr.3, Laç, Kurbin deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë pas shqyrtimit në themel të heshtjes nga ko Gjykate".

Me Vendimin nr. 62(3112202399-80-2020) Rregj. Them, datë 26.06.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, ka vendosur "Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë".

Në vijim palët paditëse në respektim të afatit 10 ditor nga marrja dijani e këtij vendimi, kane paraqitur padinë objekt gjykimi

9

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin nr. 3356, datë 15.12.2020, ka vendosur "pranimin e padisë", sipas disponimeve të pasqyruara në pjesën hyrëse të këtij vendimi, duke argumentuar ndër të tjera se:

"...Gjykata vlerëson se "Njoftimi për shembjen e pallati", datë 18.06.2020, i afishuar nga pala e paditur Bashkia Kurbin në ambientet e Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, vendodhja: Lagjia Nr.3, Laç, Kurbin, në thelb është një veprim tjetër administrativ i organit të administratës shtetërore, pasi është formë e njëanshme e veprimtarisë së organit publik, në kryerjen e funksionit publik dhe që nuk plotëson kushtet për të qenë akt administrativ apo kontratë dhe që krijon pasoja juridike mbi të drejtat subjektive apo interesat e ligjshëm të palës paditëse.

Fillimisht, kjo Gjykatë, vlerëson të theksojë se, në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, është parashikuar qartë që: "kushdo për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij ka të drejtën e njëgjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj".

Pikërisht, kjo e drejtë themelore e çdo subjekti, do të gjejë zbatim dhe aplikim dhe në ligje të veçanta, të cilat, do të parashikojnë shprehimisht thelbin e së drejtës, ku qendron ajo në kuptimin material, si dhe të drejtën subjektive të personit, për të realizuar mbrojtjen e saj, mënyrën dhe mjetet e mbrojtjes etj.

Referuar çështjes objekt gjykimi, në Kodin e Procedurave Administrative, neni 18, paragrafi "b" i tij, është parashikuar që: "Në mënyrë që të mbrohen të drejtat kushtetuese dhe ligjore të personave privatë, veprimtaria administrative i nënshtrohet: ..b) kontrollit nga gjykatat në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile", ndërsa në nenin 17 të Ligjit nr. 49/2012, është parashikuar qartësisht se: "1. Padia ngrihet: d) për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ, që nuk prodhon pasoja juridike, nëse paditësi ka një interes të arsyeshëm për këtë. Pra, në interpretim të këtyre dispozitave, legjislatori ka parashikuar në mënyrë të posaçme se, çdokush që cënohet në të drejtat dhe interesat e tij nga një veprim administrativ, ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës për mbrojtjen e tyre. E drejta për t'ju drejtuar gjykatës, është një e drejtë e patjetërsueshme, e pandashme dhe e padhunueshme, e cila është pjesë përbërëse e procesit të rregullt ligjor, parashikuar edhe nga neni 6 i KEDNJ-së. Kjo e drejtë, është në të njëjtën kohë, një prej parimeve bazë më të rëndësishme, e detyrueshme për t'u respektuar si nga gjykatat, ashtu dhe nga të gjitha institucionet e administratës shtetërore.

Pikërisht, kjo e drejtë e subjektit për të realizuar mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tij të pretenduara të shkelura nga ana e organit administrativ, do të realizohet vetëm nëpërmjet përdorimit dhe paraqitjes në gjykatë të padisë (mjeti i vetëm procedural), me anën e së cilës, ai do të vërë në lëvizje organet gjyqësore si dhe do të rivendosë në vend, këto të drejta.

Padia, është e drejta e personit që bën pretendimin për t'u dëgjuar mbi themelin e këtij pretendimi, në mënyrë që gjykata, ta shpallë atë të bazuar apo jo (neni 31 (1) i K.Pr.Civile). Pra, gjykata analizon pretendimet e paditësit, domethënë shikon nëse ka lidhje objekti i padisë me

shkakun e saj (dhe sigurisht edhe faktet e provuara gjatë gjykimit) dhe në fund e shpall të bazuar ose jo padinë. Themeli i pretendimit formulohet nga palët dhe gjykata ka detyrimin që të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet (neni 6 i K.Pr.Civile). Në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, gjykata paraqitet në rolin e një arbitri asnjans, i cili, vlerëson në mënyrë të paanshme pretendimet e palëve dhe në fund, i shpall ato të bazuara apo jo. Palët kanë të drejtë të parashitrojnë para gjykatës, interpretimin apo përcaktimin e tyre për faktet dhe të drejtat që lidhen me zgjidhjen e çështjes, por gjykata, në ushtrim të pavarësisë dhe paansisë së saj, i çmon vetë këto çështje dhe nëse i gjen të bazuara pretendimet e palëve, i pranon ato, në të kundërt i rrëzon.

Gjykata, në referim të kërkimeve të palës paditëse dhe shkakut ligjor ku ajo mbështet këto pretendime, vlerëson se, në rastin objekt gjykimi, jemi përpara një konflikti administrativ, i cili ka lidhje me kundërshtimin e një veprimi administrativ, i nxjerrë në kundërshtim me urdhërimet ligjore.

Kështu Akti Normativ Nr. 9 date 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore", ne Nenin 1 "Objekti", përcakton: "Ky akt rregullon funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre; programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

Në vijim gjykata referon në nenin 5, "Subjektet përfituese", neni 9 "Parimi i trajtimit të barabartë të shtetasve", neni 34 "Akt ekspertiza e thelluar e ndërtesave të dëmtuara", neni 35 "Prishja e detyruar".

Në interpretim të dispozitave të sipërcituara si dhe rrethanave të faktit, Gjykata vlerëson se pala e paditur Bashkia Kurbin me Vendimin Nr. 63, datë 22.04.2020 "Për miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019" ka vendosur: "Miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 bazuar në Akt ekspertizat e thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tirane ndër të cilat është edhe Pallati 84 Njësia Administrative Laç, Lagje Nr. 3".

Ndërkohë që Aktekspertiza e thelluar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, është dërguar pranë Bashkisë Kurbin me shkresën nr.1244 prot, datë 03.06.2020 protokolluar pranë Bashkisë Kurbin me Nr. 2433 prot, datë 17.06.2020 "Dërgim akt ekspertize të thelluar për ndërtesën nr. 84".

Po kështu në këtë akt ekspertimi që duhej të ishte i thelluar, nuk ka asnjë përllogaritje të vlerës së kostos së ndërtimit dhe vlerës së kostos së riparimit. Pala e paditur Instituti i Ndërtimit shprehet me një fjali të vetme pa bërë asnjë përllogaritje në kundërshtim të hapur me nenin 34 "Akt ekspertiza e thelluar e ndërtesave të dëmtuara" dhe nenin 35 "Prishja e detyruar" të Aktit Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore", duke u shprehur se: "Duke marrë parasysh statusin aktual të dëmtimit të ndërtesës, si dhe rezultatet e testeve laboratorike dhe studimit gjeologo-inxhinjorik, riparimi i ndërtesës mund të jetë i kushtueshëm dhe rrjedhimisht jo efikas, Në këto kushte do të rekomandonim prishjen e kësaj godine".

Sa me sipër Gjykata vlerëson se veprimet e palëve të paditura, janë kryer në shkelje të procedurës së nevojshme të verifikimit, vlerësimit dhe rishikimit të vendimit për shembjen e godinës, të përcaktuar shprehimisht në Aktin Normativ nr. 9, dt. 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", dhe si të tilla ato cenojnë rëndë të drejtat dhe intereset ligjshme të palës paditëse.

Ne nenin 34, Akt ekspertizë e thelluar e ndërtesave të dëmtuara, të Aktit Normativ nr. 9, dt. 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", janë parashikuar në mënyrë të detajuar gjithë procedurat e veprimeve në rastin e konstatimit të dëmtimeve të renda në banesa dhe njësi, duke u sanksionuar se: "...4. Nëse sipas studimit të thelluar, të mbështetur dhe nga opoenca e Institutit të Ndërtimit ndërhyrjet për riparimin e strukturës kushtojnë me shume se 70% e kostos së rindërtimit nga e para te ndërtesës, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës vendos shembjen e detyruar të objektit, që kryhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 35 të këtij akti. 5. Për vlerësimin e menjëhershëm dhe në çdo rast dert në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të dëmeve të ndërtesave publike ose private, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës ndjek procedurën e prokurimit me negociim pa shpallje për mbulimin e nevojës emergjente, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Procedura e prokurimit publik në këtë rast zhvillohet në forme shkresore".

Sa me sipër Gjykata vlerëson se vendimi i prishjes se objektit duhet të jetë vendimi final nëse kostoja e ristrukturimit do të ishte në masën mbi 70% të vlerës së rindërtimit nga e para.

Sikurse është arsyetuar me sipër, pala e paditur nuk ka bërë asnjë vlerësim lidhur me kostot e rindërtimit apo riparimit, ku të përllogarite vlera edhe preventivi i punimeve.

Nëse ky veprim ligjor do të ishte kryer nga palët e paditura, do të rezultonte ashtu sikurse rezulton në ekspertizën e thelluar të paraqitur nga pala paditëse në Gjykate, ku është dhënë konkluzioni nga ekspertë të licensuar nga vete Instituti i Ndërtimit në aktin e bërë privatisht se: Vlera e rindërtimit të objektit është 118.753.874 lekë të reja, ndërsa vlera e përforcimit është 40.681.451 lekë të reja, e thënë ndryshe sa 34% e vlerës së rindertimit.

Sa me sipër, Gjykata vlerëson se, vullneti i shprehur nga ana e palës së paditur, Bashkia Kurbin nëpërmjet nxjerrjes së "Njoftimit për shembjen e pallati", datë 18.06.2020, i afishuar nga pala e paditur Bashkia Kurbin në ambientet e Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, vendodhja: Lagjia Nr.3, Laç, Kurbin, si një veprim tjetër administrativ i organit të administratës shtetërore, është kryer në kundërshtim me procedurën e përcaktuar në Aktin Normativ nr. 9, dt. 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", duke krijuar pasoja juridike mbi të drejtat subjektive apo interesat e ligjshme të palës paditëse.

Sa më sipër, Gjykata çmon dhe vlerëson se procedura administrative, nuk është kryer nga pala e paditur në pajtim të Aktit Normativ nr. 9, dt. 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

....
Neni 109, i K.Pr.Administrative, titulluar "Paligjshmëria e aktit administrativ" parashikon se, Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

- a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;
- b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;
- c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;
- ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;
- d) është në kundërshtim me ligjin material;
- dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit

Neni 109 i K.Pr.Administrative rendit shtatë fusha të të metave/defekteve ligjore që çojnë në paligjshmërinë e aktit administrativ. Në këtë mënyrë, ai ndjek, ndër të tjera, qëllimin për të siguruar udhëzime specifike për praktikën administrative për zbatimin e parimit të ligjshmërisë së administratës publike siç parashikohet në nenin 4 të K.Pr.Administrative.

Tre fushat e para (shkronjat "a" - "c") përfshijnë të metat ligjore që kanë të bëjnë me kompetencën dhe rregullat procedurale të këtij Kodi. Megjithatë me formulime të ngjashme, këto tri fusha mbulohen nga nënndarjet "i" - "iii", të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 108 të K.Pr.Administrative. Katër fushat e tjera kanë të bëjnë me shkeljet ligjore kundër rregullave materiale. Tre nga shkronjat (shkronjat "ç", "d" dhe "dh") kanë të bëjnë me raste të veçanta të të metave të së drejtës materiale duke përfshirë mungesën e bazës ligjore, shpërdorimin e diskrecionit, shkeljen e parimit të proporcionalitetit.

Të metat e rasteve që klasifikohen në njërin nga shtatë kategoritë e nenit 109 çojnë në paligjshmërinë e aktit administrativ përkatës.

Për këtë arsye, gjykata, çmon se, ai është një veprim administrativ i paligjshëm, referuar nenit 109,1 pika b), pasi është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; si dhe pika d) pasi është nxjerre në kundërshtim me ligjin material; të K.Pr.Administrative dhe duhet të konstatohet i tillë, duke disponuar me konstatimin e paligjshmërisë së veprimit tjetër administrativ "Njoftim për shembjen e pallati", datë 18.06.2020, të afishuar nga pala e paditur Bashkia Kurbin në ambientet e Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, vendodhja: Lagjia Nr.3, Laç, Kurbin.

Po kështu si rrjedhojë e shkeljeve të arsyetuara me sipër, Gjykata shprehet dhe me shfuqizimin e aktit të ekspertimit të bërë nga pala e paditur Instituti i Ndërtimit, njoftuar me shkresën nr. prot 1244, dt.03.06.2020, si dhe detyrimin e palës së paditur Instituti i Ndërtimit për kryerjen e aktit të vlerësimit të kostos së ndërtimit, dhe kostos së riparimit të Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, vendodhja: Lagjia Nr.3, Laç, Kurbin.

Pasi të jetë kryer akti i vlerësimit të kostos së ndërtimit, dhe kostos së riparimit të Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, vendndodhja: Lagjia Nr.3, Laç, Kurbin nga pala e paditur Instituti i Ndërtimit, pala e paditur Bashkia Kurbin ka detyrimin për kryerjen e veprimeve administrative për riparimin e plotë të Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, vendndodhja: Lagjia Nr.3, Laç, Kurbin kjo në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 34 të Aktit Normativ nr. 9, dt. 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit

Së pari, Gjykata, vlerëson të marrë në shqyrtim kushtet e pranueshmërisë së ankimit. Sikurse është referuar edhe më sipër, në këtë vendim, rezulton që vendimi të jetë shpallur në datën 15.12.2020, në prani të palës paditëse dhe palës së paditur Bashkia Kurbin dhe në mungesë së palës së paditur Instituti i Ndërtimit dhe Avokaturës së Shtetit.

Ndërsa ankimi i paraqitur nga pala e paditur, Bashkia Kurbin, është depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 06.01.2021, pra brenda afatit pesëmbëdhjetëditor, nga komunikimi i vendimit të arsyetuar në datën 24.12.2020, të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë dhe 444 paragrafi i parë të Kodit të Procedurës Civile.

Ankimi i palës së paditur Instituti i Ndërtimi, është depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 31.12.2020, pra brenda afatit pesëmbëdhjetëditor, nga komunikimi i vendimit të arsyetuar në datën 24.12.2020, të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë dhe 444 paragrafi i parë të Kodit të Procedurës Civile.

Ankimi i Avokaturës së Shtetit, është depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 30.12.2020, pra brenda afatit pesëmbëdhjetëditor, nga komunikimi i vendimit të arsyetuar në datën 24.12.2020, të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë dhe 444 paragrafi i parë të Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata, vlerëson se, nuk ekzistojnë kriteret penguese të parashikuara në nenin 45 të ligjit nr. 49/2012 që e bëjnë vendimin të paankimueshëm. Ankimet rezultojnë të jenë të plotë në elementët e formës edhe të përmbajtjes, lidhur me nënshkrimin nga pala që e ka paraqitur ankimin, tregimin e palëve ndërgjyqëse, vendimin kundër të cilit është paraqitur, apo kërkimet për të cilat ai është paraqitur, kjo në përputhje me nenin 453 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe nenet 44 dhe 46 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar.

Konstatohet se, veprimet lidhur me njoftimin dhe dërgimin e ankimit për shqyrtim janë kryer në përputhje me nenet 44 dhe 48 të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar dhe nenin 447 të Kodit të Procedurës Civile.

Për të gjitha sa më sipër, Gjykata çmon se, nga shqyrtimi i akteve procedurale që përmban dosja gjyqësore, nuk konstatohet veprime apo mosveprime të cilat do të përbënin shkak për, prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, kjo parashikuar në nenet 50/ç dhe 54 të ligjit nr.49/2012, si edhe në nenin 476 të K.Pr.Civile. Gjykata e Shkallës së Parë, rezulton të ketë zbatuar drejtë ligjin procedural duke siguruar një proces të rregullt ligjor.

Si përfundim, Gjykata vlerëson se, ankimet e paraqitura kundër vendimit nr. 3356, datë 15.12.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë objekt gjykimi, duhet të pranohet për shqyrtim.

Së dyti; Me vendimin e ndërmjetëm të datës 14.09.2022, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë vlerësoi në dhomë këshillimi se, kjo çështje konform nenit 51/1/c të ligjit 49/2012 duhet të kalonte për shqyrtim në seancë gjyqësore, me qëllim përsëritjen e marrjes së disa ose të gjitha provave të paraqitura në gjykim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjithashtu, Gjykata vlerësoi të nevojshëm debatin gjyqësor për të përcaktuar drejtë konfliktiin objekt gjykimi si dhe shqyrtimin e Akt Ekspertizës së Thelluar dhe dhënien e oponencës nga Instituti i Ndërtimit, i cili ka ndikuar drejtpërdrejtë në marrjen e vendimit Nr.63, datë 22.04.2020 "Për miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, bazuar në Aktexpertizën e thelluar të kryer nga Instituti i Ndërtimit Tiranë" si dhe "Njoftimin për shembjen e pallati", datë 18.06.2020, të afishuar nga pala e paditur Bashkia Kurbin në ambientet e Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, Lagja Nr.3, Laç, Kurbin.

Sa më lart, Gjykata Administrative e Apelit riçeli pjesërisht hetimin gjyqësor konform nenit 465 të K.Pr.Civile, për marrjen dhe administrimin e provave me qëllim sqarimin e rrethanave faktike të çështjes objekt gjykimi. Palët e pyetura në gjykim, kanë deklaruar se nuk kanë prova të reja për të paraqitur, ndërsa Gjykata në përmbushje të detyrës së saj, për një hetim të plotë ka kërkuar nga pala e paditur Bashkia Kurbin, të jepet një informacion mbi familjet të cilat ndodhen në pallatin nr. 84, Zona Kadast rale 2363, në Lagjen Nr.3, Laç, Kurbin, mënyrën e trajtimit të tyre me bonos qeraje dhe nëse ky pallat është i banueshëm.

Bashka Kurbin me shkresën nr. 6085 prot, datë 16.11.2022 ka informuar gjykatën se në bazë të kërkesës së kryer nga banorët e pallatit, trajtohen me bonos qeraje 38 familje, ndërsa me shkresën nr. 4582/1 Prot, datë 15.11.2022 të Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kurbin është dërguar informacion në lidhje me gjendjen juridike dhe kartelat e pasurisë së

paluajtshme të pallatit nr. 84, lagja nr.3 Laç, nga ku rezulton se pasuria nr. 3/93, e llojit pallat është me 5 kate dhe 3 shkallë:

Kjo gjykatë, evidenton se gjatë gjykimit në shkallë të parë është paraqitur Akt Ekspertiza e thelluar, për objektin 84, në Bashkinë Kurbin, hartuar nga inxhinieri Fatmir Nuhaj me nr. Liçence 6803/1. Sipas përshkrimit evidentohet se, eksperti ka rekomanduar, "...struktura e objektit në gjendje ekzistuese nuk i plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë për një vend sizmik siç është Laçi dhe duhet ti nënshirohet restaurimit dhe përforcimit, mbi bazën e specifikimeve teknike të projektit përkatës bashkangjitur. Duke lu referuar kostove ndërtimore në treg, për një riaftësim strukturor me standarde cilësore dhe destinacionit si objekt banimi do të vlerësohet në një vlerë totale 40,081,451 lekë. Rekomandohej që struktura e mësipërme të përforcohet dhe të restaurohet konform projektit përkatës." Gjithashtu në akt është përcaktuar se, vlera e rindërtimit të objektit është 118.753.874 lekë, ndërsa vlera e përforcimit është 40.681.451 lekë, e thënë ndryshe sa 34% e vlerës së rindërtimit.

Gjykata, bazuar në nenin 34, pika 4 të ligjit 49/2012, në kushtet kur mosmarrëveshja objekt gjykimi kërkonte njohuri të posaçme ka lejuar marrjen e provave me dëshmitarë, duke thirrur për tu dëgjuar dhe për të dhënë shpjegime, ekspertin Fatmir Nuhaj, i cili ka hartuar aktin e ekspertimit të sipërcituar. Gjatë seancës gjyqësore të datës 05.12.2022 eksperti është shprehur se, akti i ekspertimit është hartuar me kërkesë së palës paditëse dhe pasi janë parashikuar të gjithë modelimet e objektit dhe është arritur në konkluzionin se, objekti rikonstruktohet, pasi duke vlerësuar çdo zë të punimeve deri në përforcimin e plotë të objektit dhe të gjitha zërat e tjerë ndërtimor deri sa objekti të bëhet i banueshëm, kostoja e ristrukturimit nuk ka kaluar 70% të investimit që mund të kryhet për rindërtimin e objektit.

Gjykata vëren se, vendimi nr. 63, datë 22.04.2020 i Këshillit Bashkiak Kurbin "Për miratimin e prishjes së detyrueshme të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019" është bazuar në akt ekspertimit të thelluar të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, i cili ka vendosur: "Miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.2019, bazuar në Akt ekspertizat e thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, për ndërtesa prona publike dhe private, sipas listës bashkangjitur vendimit...Sipas këtij akti është arritur në përfundimin se, "...mund të konkludojmë që kjo ndërtesë nuk ka aftësi mbajtëse të përballojë jo vetëm ngarkesat dinamike sizmike, por as ato statike. Objekti nuk ka elementet minimale antisizmike sikurse janë brezat lidhet monolitizues dhe koloncinat antisizmike. Soletat janë të para përgatitura me monolitizim pothuajse inegzistent duke mos ofruar efektin e diafragmes horizontale në ndërtesën ekzistuese. Referuar analizës së mësipërme kompjuterike dhe inspektimit në terren, duke vlerësuar të gjitha faktorët e aftësisë mbajtëse për ngarkesa statike dhe dinamike arrijmë në konkluzionin që objekti nuk plotëson kushtet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë. Objekti përbën rrezik për jetën e banorëve. Rekomandimi ynë është që ndërtesa të prishet pasi restaurimi dhe përforcimi i saj nuk do të ishin të justifikuar nga ana ekonomike".

Gjatë debatit gjyqësor, pala e paditur në këtë gjykim Instituti i Ndërtimit është pyetur nga Gjykata, për dhënien e shpjegimeve mbi hartimin e aktit të ekspertizës si dhe konkluzionet e arritura nga ana e saj. Për të dhënë shpjegime mbi këtë çështje, është paraqitur në cilësinë e përfaqësuesit të Institutit të Ndërtimit eksperti z. Altin Bidaj i cili ka deklaruar se, pallati nr. 84, Zona Kadastrale 2363, në Lagjen Nr.3, Laç, Kurbin në bazë të aktit të ekspertimit të kryer

nga subjekti privat Altea Geostudio 2000, është vendosur në një terren shumë të vogël dhe sipas saj, zona është me një rrezik shumë të lartë. Këto kanë qënë arsyet për të cilat është rekomanduar prishja e objektit. Nga ana e Institutit të Ndërtimit është bërë një vlerësim i përgjithshëm mbi situatën e ndërtimit dhe nuk janë kryer rilogaritje të kostos së rikonstruksionit/përforcimit të objektit, pra nuk kemi një vlerësim të dëmit të shkaktuar, për shkak të shkallës së rrezikshmërisë që paraqet objekti, është gjykuar që objekti kalon vlerën 70 % të dëmtimit dhe është rekomanduar prishja e objektit. Nga ana tjetër bëhet me dije se palës së paditur Institutit të Ndërtimit nuk i është dhënë si detyrë nga Bashkia Kurbin kryerja e përilogaritjeve të vlerës së rikonstruksionit apo llogaritja e vlerës së ndërtimit të ri. Ky organ publik nuk mund të shprehët mbi këtë vlerësim, pasi do të bënte konflikt në rastin konkret.

Gjatë gjykimit, palët paditëse nëpërmjet përfaqësuesit të tyre kanë pretenduar lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë dhe mospranimin e ankimeve, duke vlerësuar se, gjendemi në kushtet e paligjshmërisë së akteve objekt gjykimi. Gjithashtu, për prishjen e objektit, pala e paditur nuk rezulton të ketë kryer ndonjë vlerësim financiar nisur nga shkalla e rrezikshmërisë së objektit, ndërsa sipas aktit të ekspertimit të hartuar me kërkesë së paditësve, rezulton se objekti është në kushtet e rikonstruksionit apo përforcimit, ndryshe nga sa kanë vlerësuar palët e paditura.

Palët e paditura në këtë gjykim, Bashkia Kurbin, Instituti i Ndërtimit si dhe Avokatura e Shtetit, kanë kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrezimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Palët, gjatë gjykimit kanë pretenduar të njëjtat shkaqe sikurse kanë paraqitur dhe gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe në shkaqet e ankimit. Në vlerësimin e tyre, objekti paraqet rrezikshmëri të lartë për banim, dhe gjendet në kushtet e vlerësimit, për prishjen e tij, pasi rikonstruksioni/përforcimi i strukturës me të gjithë elementët do të arrinte një vlerë më të lartë se 70% e kostos së rindërtimit.

Së treti, Nisur nga shkakut ligjor i kërtimeve të paditësve, kjo Gjykatë vlerëson se konflikti objekt gjykimi është i natyrës administrative. Konflikti mes palëve, është krijuar si pasojë e miratimit të vendimit të Këshillit Bashkiak Kurbin, nr. 63, datë 22.04.2020 "Për miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019." si dhe kryerjes së "Njoftimit për shembjen e pallati", datë 18.06.2020, të afishuar nga pala e paditur Bashkia Kurbin në ambientet e Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, Lagja Nr.3, Laç, Kurbin. Referuar natyrës së mosmarrëveshjes dhe fushës së zbatimit të saj, Gjykata Administrative e Apelit evidenton se kërkimet e paditësve, gjejnë rregullim në aktin normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", VKM nr. 26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara" si dhe dispozitat e Kodit të Procedues Administrative.

Rezulton në këtë gjykim, se paditësit Ylli Tuga, Gjok Çoba, Shefqet Basha dhe Arjan Çoba, janë banorë të qytetit të Laçit dhe kanë në pronësi pasuri të paluajtshme të llojit "apartamente dhe njësi shërbimi" të cilat ndodhen në pallatin nr. 84, Zona Kadastrale 2363, në Lagjen Nr.3, Laç, Kurbin. Si pasojë e lëkundjeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, pallati i paditësve, ka pësuar dëmtime.

Me shkresën nr. 2456/1 prot, datë 19.06.2020, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit, Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Kurbin, ka bërë me dije paditësit se janë krijuar grupet e punës të cilët kanë kryer verifikimet përkatës, Konkretisht në datën 06.12.2019, është kryer inspektimi i pallatit nr. 84, lagja 3, Kurbin nga ku ka rezultuar se, është një godinë me dëmtime të mesme dhe i pabanueshëm në të tre shkallët, kjo deri në hartimin e Aktit të Analizës së Thelluar nga Instituti i Ndërtimit.

Me shkresën nr. 1244 prot, datë 03.06.2020 protokolluar pranë Bashkisë Kurbin me nr. 2433 prot, datë 17.06.2020, Instituti i Ndërtimit ka përcjellë aktin "Dërgim akt ekspertize të thelluar për ndërtesën nr 84" ku në pikën 3 "konkluzione" veç të tjerash citohet "...Si konkluzion, në tërmetin me magnitudë 6.4 të nëntorit 2019, shkatërrimi i llaçit, puna jashtë planit të mureve mbajtës nga përdredhja dhe çarjet e shkaktuara nga forcat prerëse kanë shkaktuar dëme të rënda. Sidoqoftë, ky termet është dukshëm me i vogël se tërmeti i projektimit sipas Eurokodit 8. Duke marrë parasysh statusin aktual të dëmtimit të ndërtesës, si dhe rezultatet e testimeve laboratorike dhe studimit gjeologo-inxhinjerik, riparimi i ndërtesës mund të jetë i kushtueshëm dhe rrjedhimisht jo efikas, Në këto kushte do të rekomandonim prishjen e kësaj godine".

Më tej, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Kurbin ka miratuar vendimin nr. 63, datë 22.04.2020 me të cilin është vendosur miratimi i prishjes së detyruar të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.2019, bazuar në Aktekspertizat e thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tiranë, për ndërtesa prona publike dhe private, sipas listës bashkangjitur vendimit.

Sipas aktit të ekspertimit të kryer nga subjekti privat "Altea Geostudio 2000" sh.p.k, në lidhje me objektin e gjykimit, në të cilën është bazuar dhe Instituti i Ndërtimit është arritur në përfundimin se: "... Nga të dhënat e studimit gjeologo – inxhinierike rezulton se themeli i pallatit nr. 84, në qytetin e Laçit është i mbështetur mbi depozitime të dobta, kjo ka bërë që pallati të mos i rezistojë tërmetit të datës 26.11.2019.

Nëqoftëse do të ndërtohet një pallat i ri rekomandojmë që si mënyrë themelimi të përdoren themele të thella të mbështetura në shtresën e depozitimeve të Neogjenit ose themele të cekta, por duke e përmirësuar tokën natyrore me një shtresë artificiale me material granular zhavorr ose shkëmb i thyer. Shtresa artificiale duhet të ngjeshët deri në 98% e ngjeshjes në laborator. Por para ndërtimit të pallatit të ri duhet të kryhet një studim i detajuar gjeologo inxhinierike. Rekomandojmë që materialet që do të përdoren të jenë me granulometri të rregullt 0-70mm dhe treguesi i plasticitetit të jetë më i madh se 5 dhe CBR më e madhe se 40%."

Duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e palës së paditur, për shkaqet e sipërcituara, paditësit i janë drejtuar gjykatës me padinë me objekt gjykimi, të cilët në kërkimin e tyre kanë ngritur njëkohësisht pretendime mbi element të pavlefshmërisë dhe paligjshmërisë së akteve objekt gjykimi, të cilat në thelb kanë të bëjnë me procedurën dhe përmbajtjen e elementëve bazë të aktit të ekspertizës të kryer nga pala e paditur Instituti i Ndërtimit, konkluzionet e së cilës kanë diktuar miratimin e VKB nr. 63, datë 22.04.2020 "Për miratimin e prishjes së detyrueshme të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019, bazuar në aktekspertimin e thelluar të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tiranë".

Lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes, Gjykata i referohet parimit të gjykimit administrativ të sanksionuar në nenin 37 të ligjit nr. 49/2012 sipas të cilit "Gjykata shqyrton ligjshmërinë e

veprimi administrativ që kundërshtohet, në bazë të provave të paraqitura nga palët dhe të situatës ligjore dhe faktike që ekzistonte në kohën e kryerjes së veprimit konkret administrativ”.

Pavarësisht mënyrës se si e kanë formuluar paditësit kërkimin e tyre, në analizë të shkaktuar ligjor të kërtimeve të palëve, si dhe çfarë kanë pretenduar gjatë debati gjyqësor dhe konkluzioneve të tyre, rezulton se, paditësit në këtë gjykim kanë pretenduar pavlefshmëri absolute dhe paligjshmëri (pavlefshmëri relative) të cilat lidhen respektivisht me i) shfuqizimin e aktit të ekspertimit të bërë nga pala e paditur Instituti i Ndërtimit, njoftuar me shkresën nr. prot 1244, datë 03.06.2020, si akt i paplotë i pambështetur në ligj dhe në prova; ii) paligjshmëri e veprimi tjetër administrativ, "Njoftim për shëmujen e punëve", datë 18.06.2020, të cështur nga pala e paditur Bashkia Kurbin në ambientet e Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, Lagja Nr.3, Laç, Kurbin, iii) Detyrimin e palës së paditur Instituti i Ndërtimit për kryerjen e aktit të vlerësimit të kostos së ndërtimit, dhe kostos së riparimit të Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, Lagja Nr.3, Laç, Kurbin; si dhe vi) detyrimin e palës së paditur Bashkia Kurbin për kryerjen e veprimeve administrative për riparimin e plotë të Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, Lagja Nr.3, Laç, Kurbin, kërtime këto të cilat kanë si burim pavlefshmëri e aktit të ekspertimit të miratuar nga Instituti i Ndërtimit, në vlerësim të të cilit Bashkia Kurbin ka miratuar VKB nr. 63, datë 22.04.2020, me të cilën është vendosur prishja e objektit.

Në vlerësim të këtij kërkitimi, Gjykata, vepron duke marrë në konsideratë dhe qëndrimet e konsoliduara në jurisprudencën tonë, të cilat referojnë në unifikimin e praktikave gjyqësore, konkretisht, vendimi unifikues nr. 3, datë 29.03.2012 i Kolegjit të Bashkuar të Gjykatës së Lartë.

Për t'i dhënë zgjidhje kërtimeve, Gjykata, së pari vlerëson të marrë në shqyrtim kushtet për pavlefshmëri absolute të akt ekspertizës së thelluar të bërë nga pala e paditur Instituti i Ndërtimit Tiranë, njoftuar me shkresën nr. prot 1244, datë 03.06.2020, pranë Bashkisë Kurbin, objekt kundërshtimi, dhe në rast se ky kërkitim është i pabazuar në ligj të kontrolloje gjyqësish nëse jemi apo jo para paligjshmërisë së aktit (pavlefshmëri relative).

Çështjet që shtrohen për diskutim para kësaj gjykate është (i) A është akt ekspertizë e bërë nga pala e paditur Instituti i Ndërtimit, brenda kompetencave që i ka lejuar ligji, këtij organi kolegjial dhe A është nxjerrë ai sipas parashikimeve ligjore, në aspektin procedural si dhe në formën dhe elementët e tjerë detyrues të aktit?

Për t'i dhënë përgjigje pyetjes së mësipërme, kjo gjykatë vlerëson të analizojë se pavlefshmëria absolute e një akti administrativ është një nga format më të rënda të pavlefshmërisë së aktit. Në kuptimin e së drejtës, akte administrative absolutisht të pavlefshme janë ato akte, të cilat për shkak të shkeljes thelbësore të ligjeve mbi bazën e të cilave janë nxjerrë nuk kanë fuqinë e një akti administrativ të vlefshëm dhe objektivisht nuk konsiderohen që të kenë ekzistuar në asnjë çast.

Një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm, që nga momenti i nxjerrjes së tij, nuk krijon dhe as mund të krijojë pasojat juridike për të cilat ai është nxjerrë. Një akt absolutisht i pavlefshëm nuk është akt, ai është një nulitet i plotë, i cili konsiderohet se nuk ka hyrë në fuqi asnjëherë. Për shkak të shkeljes së rëndë thelbësore të ligjit, pavlefshmëria absolute e një akti nuk mund të rregullohet në të ardhmen, as nga palët dhe as nga organi që ka lëshuar aktin, pasi ky akt

konsiderohet sikur nuk ka ekzistuar asnjëherë. Si i tillë ai nuk mund të ketë fuqi detyruese, as ndaj personave apo subjekteve, të cilëve iu kundërdrejtohet dhe as ndaj organeve të tjera të administratës shtetërore.

Kur kërkohet konstatimi i pavlefshmërisë absolute të një akti administrativ, gjykatat duhet të hetojnë e gjykojnë vetëm ekzistencën e shkaqeve ligjore që i përkasin këtij lloj kërkimi, të cilat janë të parashikuara shumë qartë në nenin 108 dhe 110 të K.Pr.Administrative.

Këto dispozita shprehimisht thonë, neni 108: "*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm*", përcakton se:

Akti administrativ është absolutisht i pavlefshëm në rastet e mëposhtme:

a) kur vjen në kundërshtim të hapur dhe flagrant me një dispozitë urdhëruese të këtij Kodi dhe legjislacionit në fuqi lidhur me:

i) kompetencën e organit publik;

ii) procedurën e nxjerrjes së tij, ose

iii) formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit;

b) është nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale;

c) ekzekutimi i aktit mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal;

c) në çdo rast tjetër të parashikuar shprehimisht në ligj.

Neni 110 "*Pasojat dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute*", përcakton se:

1. Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston.

2. Pavlefshmëria absolute e aktit mund të konstatohet në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, të çdo të interesuari, nga organi publik që e ka nxjerrë atë, organi epror i tij apo organi që është kompetent të shqyrtojë mjetet ligjore administrative, si dhe nga gjykata kompetente për çështjet administrative, sipas ligjit.

3. Në rast se një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme dhe kjo pjesë është aq e rëndësishme saqë organi publik nuk do ta kishte nxjerrë aktin pa të, i gjithë akti është i absolutisht i pavlefshëm.

Në analizë të dispozitave të mësipërme, rezulton se si kriter kryesor për të dalluar pavlefshmërinë absolute nga ajo relative/paligjshmërinë është pikërisht shkalla e shkeljes së ligjit, rrezikshmëria e aktit, shkalla e mundësisë së eliminimit të shkeljes nga vet organi që ka nxjerrë aktin etj. Jurisprudenca jonë vendimet e Gjykatës së Lartë kanë krijuar tashmë një praktikë të konsoliduar, përsa i përket trajtimit të shkaqeve që çojnë në pavlefshmërinë absolute të një akti administrativ. Një nga rastet e pavlefshmërisë absolute është dhe rasti "*kur akti administrativ nxirret nga një organ administrativ në kundërshtim me procedurën apo edhe formën ose elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit*". Çdo organ është kompetent në fushën që ai mbulon dhe këtë veprimtari e ushtron vetëm brenda kompetencave që i ka dhënë ligji dhe në respektim të parimit të ligjshmërisë.

Bazuar në nenin 12 "*Autoritetet përgjegjëse*" të VKM 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", është parashikuar se: "*Autoritetet përgjegjëse për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore janë... d) Njësitë e vetëqeverisjes vendore.. Në nenin 34 të këtij akti normativ, janë parashikuar në mënyrë shteruese detyrat e Institutit të Ndërtimit në këtë*

proces, në të cilin përcaktohet se "... Aktekspertiza e thelluar i nënshtrohet oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit dhe opinioni i tij mbizotëron mbi atekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse.". Ndërsa në pikën 4 të këtij nenit parashikohet se, "...Nëse sipas studimit të thelluar, të mbështetur dhe nga oponenca e Institutit të Ndërtimit, ndërhyrjet për riparimin e strukturës kushtojnë më shumë se 70% e kostos së rindërtimit nga e para të ndërtesës, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës vendos shembjen e detyruar të objektit, që kryhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 35 të këtij akti..."

Për zbatimin e aktit normativ të sipërcituar, ligjvënësi ka miratuar VKM nr.26, datë 15.01.2020 "Për kryerjen e atekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara", në të cilën është përcaktuar se "1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore do të kryejnë atekspertizë të thelluar për të gjitha objektet për të cilat kërkohet një rivlerësim më i thelluar, mbështetur në aktkonstatimet ose aktvlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo të grupeve përkatëse të inspektimit. 2. Aktekspertiza e thelluar i vihet në dispozicion Institutit të Ndërtimit për kryerjen e oponencës. Instituti i Ndërtimit jep opinionin e tij, i cili mbizotëron mbi atekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse."

Në mënyrë të qartë, norma ligjore ka përcaktuar këtë institucion, Institutin e Ndërtimit, si të vetmin autoritet shtetëror për të kryer oponencën në lidhje me akt ekspertimin e thelluar, për vlerësimin e objekteve të dëmtuara, për të cilat është e rëndësishme të përcaktohet shkalla e rrezikshmërisë së objektit si dhe të kryhet vlerësimi financiar në lidhje me koston e rindërtimit, e parë kjo në raport krahasimor me koston e riparimit të strukturës së objektit, në masë jo më të lartë se 70% e kostos së rindërtimit.

Gjykata vëren se, ligjvënësi në VKM nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore", rregullon funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse. Ky akt ka përcaktuar në mënyrë shteruese subjektet përfutuese në kuptim të nenit 5 të tij si dhe trajtimin e barabartë të shtetasve sikurse parashikon neni 9 i VKM-së. Ligjvënësi në mënyrë të veçantë është ndalur në hartimin e aktit të ekspertizës së thelluar, pasi në bazë të konkluzioneve të arritura në të, për ndërtesat që kanë pësuar dëme dhe që janë shpallur të pabanueshme, organet e pushtetit vendor, me pushtetin që i ka dhënë ligji disponojnë mbi riparimin e strukturave ekzistuese apo me shembjen dhe rindërtimin e objektit.

Neni 34, "Aktekspertiza e thelluar e ndërtesave të dëmtuara", e Aktit Normativ nr. 9, dt. 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore", ka parashikuar në mënyrë të detajuar gjithë procedura e veprimeve në rastin e konstatimit të dëmtimeve të rënda në banesa dhe njësi, duke u sanksionuar se: "...2. Aktekspertiza e thelluar përmban, përveç të tjerave, përshkrimin e hollësishëm të gjendjes së objektit, dëmet e pësuar, gjendjen strukturore, masat për riparimet dhe ndërhyrjet që duhen kryer për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit të njerëzve, si dhe vlerën financiare për këto ndërhyrje. Ekspertiza jep një konkluzion të qartë

mbi gjendjen strukturore, nëse objekti mund të riparohet apo struktura e tij është dëmtuar në atë masë që dikton prishjen e detyruar të objektit.

...4. Nëse sipas studimit të thelluar, të mbështetur dhe nga opoenca e Institutit të Ndërtimit ndërhyrjet për riparimin e strukturës kushtojnë me shume se 70% e kostos së rindërtimit nga e para të ndërtesës, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës vendos shembjen e detyruar të objektit, që kryhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 35 të këtij akti."

Në interpretim të parashikimeve të nenit 34 të aktit normativ nr. 9/2019, duke u ndalur kryesisht në pikën 2, vërehet se ligjvënësi në mënyrë të detajuar ka parashikuar elementët bazë që duhet të jenë pjesë e aktekspertizës së thelluar, siç janë i) përshkrimin i hollësishëm i gjendjes së objektit, dëmet e pësuar, gjendjen strukturore, masat për riparimet etj; ii, konkluzionet e aktit të ekspertizës mbi gjendjen strukturore, nëse objekti mund të riparohet apo struktura e tij është dëmtuar në atë masë që dikton prishjen e detyruar të objektit. si dhe ii) vlerën financiare për këto ndërhyrje. Në kushtet kur vendimi për prishjen e objektit diktohet nga parashikimet e nenit 35 të aktit normative, rrjedhimisht ky akt konsiderohet si akti përfundimtar, për prishjen e objektit dhe për nxjerrjen e tij organet përkatëse, në rastin konkret, Këshilli Bashkiak i Bashkisë Kurbin, ka kompetencën e nxjerrjes së aktit për prishjen e objektit, por këto veprime ligjvënësi i ka parashikuar në mënyrë të kontrollueshme dhe të zbatueshme vetëm në kushtet që ato plotësojnë për nxjerrjen e tyre, duke shmangur në këtë mënyrë çdo formë abuzimi apo shmangien e çdo gabimi të mundshëm. Këshilli Bashkiak i Bashkisë Kurbin, mund të nxjerri vendimin për prishjen e objektit, por vetëm pasi të ketë marrë në shqyrtim aktin e ekspertimit të thelluar, duke konstatuar çdo element të rëndësishëm të këtij akti, ku një nga elementët kryesore është parashikimi i vlerës financiare për rikonstruksionin e objektit e parë kjo në raport me vlerën financiare të rindërtimit, vlerësim ky i cili nuk është kryer në aktin e ekspertimit të subjekti privat Altea Geostudio 2000 sh.p.k apo në opoenecën e dhënë nga Instituti i Ndërtimit.

Sa me sipër, Gjykata vëren se vendimi i prishjes së objektit, në kuptim të nenit 35 "Prishja e objektit" të VKM nr.9/2019 është vendimi final dhe kryhet në çdo rast kur ndërtesa është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore dhe nuk mund të riparohet ose kur përbën rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, sipas përfundimeve në aktkonstatimet apo aktvlerësime paraprake të Institutit të Ndërtimit ose në aktekspertizën e thelluar. Ndërsa pika 4 e nenit 34 të aktit normative, kushtëzon prishjen e objektit në mënyrë të detyrueshme, kjo në kushtet kur riparimet e strukturës kushtojnë më shumë se 70% e kostos së rindërtimit nga e para të ndërtesës, është pikërisht ky kusht që, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës vendos shembjen e detyruar të objektit.

Gjykata vlerëson se, akti i ekspertizës të thelluar i hartuar nga Instituti i Ndërtimit, i përcjellë pranë palës së paditur, Bashkia Kurbin nëpërmjet shkresës nr. prot 1244, datë 03.06.2020, është një akt i vesuar në lidhje me elementët e detyrueshëm të përmbajtjes së aktit dhe zbatimit të procedurës, pasi në të nuk jepet në mënyrë narrative, vlerësimi ekonomik i kostos së rindërtimit e krahasuar ajo në % me koston e rikonstruksionit/përforcimit të strukturës ekzistuese të objektit. Mungesa e elementëve të rëndësishëm të aktit, sikurse është në rastin konkret, përlllogaritja e kostos financiare, në aktin e ekspertizës së thelluar e bën këtë akt të cenuar dhe dikton elementë të pavlefshmërisë së aktit në kuptim të nenit 108 të K.Pr.Administrative, në kushtet kur kjo shkelje është e asaj rëndësie e cila e bën aktin e pavlefshëm.

Në kushtet kur, rezultoi tërësisht e provuar se, palët e paditura nuk kanë respektuar procedurën që duhen ndjekur për hartimin e aktit të ekspertizës të thelluar me të gjithë elementët e saj sikurse ka diktuar ligjvënësi, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, akti i ekspertimit të bërë nga pala e paditur Instituti i Ndërtimit, njoftuar me shkresën nr. prot 1244, datë 03.06.2020, është akt i marrë në shkelje të rëndë të procedurës dhe si rrjedhojë plotëson kushtet për të qënë absolutisht i pavlefshëm e si i tillë ai duhet të shfuqizohet.

Së katërti; Në lidhje me kërkimin për konstatimin e paligjshmërisë së veprimit tjetër administrativ "Njoftim për shembjen e pallati", datë 18.06.2020, të afishuar nga pala e paditur Bashkia Kurbin në ambientet e Pallatit nr. 84, Zona Kadasraie 2363, Lagja Nr.3, Laç, Kurbin.", Gjykata vëren se, ky kërkim është i bazuar e si i tillë duhet të pranohet.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se njoftimi i kryer nga pala e paditur Bashkia Kurbin është në vetvete një akt administrativ dhe sjell pasoja direkte për paditësit. Zbatimi i njëanshëm i tij, përbën cenim të interesit të ligjshëm të palës paditëse që lidhet me shembjen e pronës së tyre. Në pikën 2 të nenit 2 të ligjit nr. 49/2012 akti administrativ individual përcaktohet si "çdo vullnet i shprehur i organit publik në ushtrim të funksionit të tij publik, ndaj një ose disa subjekteve individualisht të përcaktuara të së drejtës, që krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete".

Referuar nenit 105 të K.Pr.Administrative përcaktohet se: "akti administrativ nuk është gjë tjetër, veçse çdo vendim, urdhër apo veprim që merret nga autoritetet administrative për rregullimin e një marrëdhënieje konkrete të posaçme ose rasteve të përgjithshme në sferën e të drejtës." Kodi i Procedurave Administrative parashikon qartë të gjithë elementet që duhet të përmbajë akti administrativ, si dhe rëndësia e arsyetimit të aktit, të cilat, përbëjnë dhe atë që quhet, qëllimi i nxjerrjes së aktit administrativ.

Gjykata Administrative e Apelit në vijim të analizës së mësipërme vlerëson se, "Njoftim për shembjen e pallati", datë 18.06.2020 të nxjerra nga Bashkia Kurbin, objekt i këtij shqyrtimi gjyqësor përbën akt administrativ pasi ai përmbush të gjithë elementët formalë për të qënë një akt i tillë. Ky akt është në formë shkresore, është me karakter individual drejtuar banorëve të pallatit objekt gjykimi, ka treguar qëllimin e tij dhe është nxjerrë nga një organ i qeverisjes vendore Bashkia Kurbin që ushtron aktivitetin dhe veprimtarinë e saj në baze të ligjit organik nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" ndërsa njoftimi i referohet parashikimeve të aktit normativ nr.9/2019. Ky qëndrim vjen në harmoni dhe me konkluzionet e arritura nga jurisprudenca jonë me vendimin nr. 00 – 2022 – 441, datë 21.03.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Njoftimi për prishjen e pallatit është kryer pasi pala e paditur Këshilli Bashkiak pranë Bashkisë Kurbin me vendimin Nr. 63, datë 22.04.2020 ka vendosur: "Miratimin e prishjes së detyruar të ndërtesave prona publike dhe prona private të dëmtuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 bazuar në Akt ekspertizat e thelluara të kryera nga Instituti i Ndërtimit Tirane ndër të cilat është edhe Pallati 84 Njësia Administrative Laç, Lagje Nr. 3". Në kuptim të parashikimeve të VKM nr.9/2019, akti përfundimtar për mbylljen e gjithë procesit është pikërisht nxjerrja e vendimit të prishjes së objektit, nga organet e pushtetit vendor, dhe në vijim të saj është kryer njoftimi për prishjen e objektit. Në kushtet kur, në këtë gjykim, u provua pavlefshmëria e aktit të ekspertizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit, rrjedhimisht të gjitha aktet e dala në zbatim të saj humbasin ligjshmërinë e tyre.

Së pesti; në lidhje me kërkimin për "Detyrimin e palës së paditur Bashkia Kurbin, për kryerjen e veprimit administrativ, për riparimin e plotë të pallatit nr. 84, Lagja 3, Laç", gjykata vlerëson se është i pabazuar në ligj dhe në prova dhe si i tillë duhet të rrezohet, pasi vendimmarrja mbi riparimin e pallatit, diktohet nga akti i ekspertimit të thelluar, i cili duhet të jetë shprehur mbi shkallën e rrezikshmërisë, të jetë hartuar sipas VKM nr.26, datë 15.1.2020 "Për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara" si dhe të jetë shprehur për koston financiare. Në këtë gjykim u arsyetuar se, akti i ekspertimit të thelluar i komunikuar nga Instituti i Ndërtimit me shkresën nr. prot 1244, datë 03.06.2020 është absolutisht i pavlefshëm dhe si rrjedhojë kjo gjykatë është në kushtet e pamundësisë për të disponuar mbi këtë kërkim.

Kjo gjykatë vlerësuar se, thelbi i kërkit ligjor të paditësit është detyrimi i palës së paditur për të nxjerrë aktin administrativ në lidhje me riparimin e plotë të pallatit nr. 84, Lagja 3, Laç. Neni 2, pika 5 e ligjit nr. 49/2012 parashikon shprehimisht se: "Mosveprim administrativ është çdo mungesë veprimi nga organi i administratës publike për të ushtruar veprimtarinë administrative sipas funksionit publik që krijon pasojë juridike mbi të drejta subjektive apo interesa të ligjshëm". Neni 17, pika 1, germa (ç) e ligjit nr. 49/2012 parashikon shprehimisht se: "I. Padia ngrihet: ç) për të detyruar organin publik të kryejë një veprim administrativ, që është refuzuar, apo për të cilin organi publik ka heshtur, ndonëse ka pasur kërkesë". Duke ju referuar objektit të kërkesë padisë për të cilën paditësi ka ekskluzitetin e plotë në lidhje me disponimin e objektit të saj, kjo Gjykatë konstaton se paditësi nëpërmjet kërkesë padisë së paraqitur ka si qëllim që të detyrojë palën e paditur që të marrë në shqyrtim dhe të disponojë me vendim mbi riparimin e objektit të dëmtuar.

Sipas nenit 12 të VKM nr.9/2019, përcaktohet se një nga autoritetet përgjegjëse në këtë proces është d) Njësitë e vetëqeverisjes vendore", ndërsa në nenin 34, pika 1 e tij, rezulton se, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore me qëllim garantimin e jetës dhe shëndetit, mund të kryejnë akt ekspertizë të thelluar sipas procedurës të përcaktuar në këtë nen. Akt ekspertizë e thelluar kryhet dhe për të gjitha ato objekte kur sipas aktkonstatimeve ose aktvlerësimeve paraprake të Institutit të Ndërtimit apo grupeve përkatëse të inspektimit, kërkohet një rivlerësim më i thelluar.

Sa më lart, kjo gjykatë çmon se organi administrativ i paditur Instituti i Ndërtimit dhe Bashkia Kurbin, në zbatim të parashikimeve ligjore ka detyrimin që të marrin të gjitha masat për të kryer aktekspertizën e thelluar me të gjithë elementët e saj përfshirë këtu dhe vlerën financiare për këto ndërhyrje., duke disponuar në varësi të përmbushjes së kritereve ligjore me akt administrativ për dhënien e vendimit mbi prishjen e objektit ose riparimit të saj nëse kjo vlerë do të jetë në masë më të vogël se 70% nga kostoja e rindërtimit, sikurse parashikon nenin 34, pika 4 e VKM nr.9/2019. Kjo gjykatë vlerëson se, organi administrativ ka pasur të gjitha mundësitë, kohën e mjaftueshme, gjithë dokumentacionin dhe mekanizmat ligjore që sipas kushteve të parashikuar në aktin nënligjor të shprehej me një vendim të drejtë të bazuar në një aktekspertizë të thelluar dhe të vlefshme në të gjithë komponentët e saj.

Kjo gjykatë vlerëson se, sikurse u arsyetua dhe më lartë, ka qenë detyrim i palës së paditur Instituti i Ndërtimit Tiranë dhe Bashkisë Kurbin që të hartojnë aktekspertizën e thelluar, përfshirë këtu dhe kostot financiare të riparimit apo të rindërtimit të Pallatit nr. 84, Zona

Kadastrale 2363, Lagja Nr.3, Laç, Kurbin, në kuptim të nenit 34 të VKM-nr. 9/2019 si dhe VKM nr.26, datë 15.1.2020, vetëm pasi të dalin kostot përkatëse, pala e paditur Bashkia Kurbin, ka të drejtë të dali me vendimmarrje mbi mënyrën se si do të trajtohet objekti i dëmtuar.

Për sa më sipër, kjo gjykatë vlerëson se, gjykata e shkallës së parë ka zgjidhur pjesërisht drejtë mosmarrëveshjen, duke cilësuar faktet në bazë të provave të paraqitura dhe interpretuar korrekt të dispozitave ligjore të zbatueshme, përsa i përket disponimit mbi "Detyrimin e palës së paditur Instituti i Ndërtimit të kryej aktin e vlerësimit të kostos së ndërtimit, dhe kostos së riparimit të Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, Lagja Nr.3, Laç, Kurbin", ndërsa në lidhje me deponimin mbi "Detyrimin e palës së paditur Bashkia Kurbin për kryerjen e veprimeve administrative për riparimin e plotë të Pallatit nr. 84, Zona Kadastrale 2363, vendodhja: Lagja Nr.3, Laç, Kurbin", kjo gjykatë, sikurse u arsyetua dhe më lartë vlerëson se, është e drejtë e organit publik të disponoj në varësi të përmbushjes së kriterëve ligjore me akt administrativ për dhënien e vendimmarrjes mbi riparimin apo prishjen e plotë të objektit sipas parashikimeve të nenit 34 dhe 35 të VKM nr. 9/2019.

Për të gjitha sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson pjesërisht të bazuara në ligj e prova pretendimet e parashtruara në ankim nga palët e paditur dhe Avokatura e Shtetit, pasi vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është marrë pjesërisht në kundërshtim me ligjin vetëm përsa i përket detyrimit të palës së paditur, Bashkia Kurbin, për kryerjen e veprimit administrativ në lidhje me riparimin e plotë të pallatit, objekt gjykimi, pasi ky diskonim duhet të kryhet nga pala e paditur Bashkia Kurbin nën fuqinë e ligjit, nëpërmjet vendimmarrjes së saj duke u bazuar në një aktekspertisë të thelluar në përmbajtje të së cilës të jenë trajtuar në mënyrë të qartë i) përshkrimin i hollësishëm i gjendjes së objektit, dëmet e pësuarra, gjendjen strukturore, masat për riparimet etj; ii) konkluzionet e aktit të ekspertizës mbi gjendjen strukturore, nëse objekti mund të riparohej apo struktura e tij është dëmtuar në atë masë që dikton prishjen e detyruar të objektit, si dhe ii) vlerën financiare për këto ndërhyrje.

Në këto kushte, kjo Gjykatë vlerëson se, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë nuk ka analizuar drejt në kuptim të nenit 17/2 të Ligjit Nr.49/2012, faktet dhe veprimet e lidhura me këtë mosmarrëveshje, duke mos identifikuar dispozitat e detyrueshme për tu zbatuar prej saj, shkaqe që çojnë dhe në ndryshimin pjesërisht të këtij vendimi.

Shpenzime gjyqësore lidhur me këtë çështje në Gjykatën Administrative e Apelit, nuk u kryen.

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në Nenin 53 gërma b të ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", i ndryshuar

VENDOSI

- Ndryshimin pjesërisht të vendimit nr. 3356, datë 15.12.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë.
- Konstatimin e paligjshmërisë së veprimit tjetër administrativ "Njoftim për shembjen e pallatit" datë 18.06.2020 të afishuar nga pala e paditur Bashkia Kurbin në ambientet e pallatit nr. 84 zona kadastrale 2363, vendndodhje Lagja nr. 3 Laç, Kurbin.

- Shfuqizimin e aktit të ekspertizës të bërë nga pala e paditur Instituti i Ndërtimit, njoftuar me shkresën nr. 1244 Prot., datë 03.06.2020.
- Detyrimin e palës së paditur Bashkia Kurbin në bashkëpunim me Institutin e Ndërtimit për kryerjen e aktit të vlerësimit të kostos së ndërtimit dhe kostos së riparimit të pallatit nr. 84, zona kadastrale 2363, vendndodhja Lagjia nr.3, Laç, Kurbin.
- Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.
- Ligjërimin e masës së sigurimit të padisë vendosur me vendimin nr. 62 regjistrimi, date 26.06.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
- Ky vendim përbën titull ekzekutiv, të detyrueshëm për tu zbatuar nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor menjëherë.
- Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.
- Kundër këtij vendimi lejohet rekurs në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë brenda 30 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.
- U shpall sot me datë 12.12.2022 Tiranë.

ANËTARE
BLERONA HASA

ANËTAR
ARDIAN DYÇRANI

RELATORE
ENKELEJDA METALIAJ(SOFTA)